



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:  
“Higjenist Dentar”  
Koleji Universitar “REALD”**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof.Dr. Mirela Lika (Çekani)**

**Prof.Asoc. Rezarta Kalaja**

**Dhjetor / 2023**



**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**  
**Bachelor në “Higjenist Dentar”**

1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “REALD”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti Stomatologjise
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në: “Higjenist Dentar”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR Nr. 249, datë 24.07.2020
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Italiane
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	11 PAE / 7 PAK
18	Numri i studentëve:	2020-2021 38 studentë; 2021-2022 11 studentë; 2022-2023 7 studentë;
19	Komente / të tjera:	




## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i Studimit i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Higjenist Dentar”, është licensuar sipas Urdhërit të MASR Nr. 249, datë 24.07.2020, i cili ofrohet nga Departamenti i Stomatologjisë, pranë Fakultetit të Shkencave Mjeksores, Kolegji Universitar “REALD”.

Programi ofrihet me 180 kredite, kohëzgjatje 3 vite akademike / 6 semestra, në gjuhën italiane me formë studimi me kohë të plotë. Ky program i përgjigjet nevojës së tregut duke u përballur me sfidat e kohës jo vetëm në zonën ku zhvillohet Vlorë, por edhe në nivel Kombëtar. Baza për arritjen e këtij qëllimi është eksperiencia e personelit akademik të Departamentit të Stomatologjisë, si edhe të programit të studimit.

Ky program studimi paraqet interes për studentët, për faktin që ofron mundësi punësimi në fushën e stomatologjisë. Organizimi është bërë në mënyrë që të arrihet një harmonizim sa më i mirë i leksioneve, seminareve dhe orëve laboratorike duke u fokusuar në ndërthurjen e teorisë me praktikën laboratorike në përputhje me natyrën e formimit për profesionin e higjenistit dentar që ofron ky program studimi dhe duke respektuar legjislacionin në fuqi: Ligji Nr. 80/2015 të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor për IAL-të në Republikën e Shqipërisë, VKM Nr. 41, datë. 24.01.2018 dhe VKM Nr.875, datë 18.12.2019.

Në dispozicion të studentëve, si dhe për realizimin me sukses të këtij programi studimi është një infrastrukturë bashkëkohore profesionale dhe didaktike, duke përfshirë këtu jo vetëm auditorët, por edhe laboratorët mësimorë, bibliotekën, përdorimin e internetit, si dhe të gjitha fasilitetet e tjera që mundësojnë një mësimdhënie cilësore.

Institucioni bashkëpunon me institucione të ndryshme publike dhe private, ku mundëson jo vetëm formimin profesional të studentëve, por edhe ndihmon dhe mbështet studentët në rrugën e punësimit. Kjo mbështetet nga mjaft marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike apo private, si dhe me sektorin e stomatologjisë.



## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM.**

Në datën 06.10.2022, Kolegji Universitar "REALD", ka dorëzuar pranë ASCAL formularin e aplikimit për akreditimin e programit të studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Higjenist Dentar". ASCAL bazuar në "Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, 2017" ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga KU "REALD", për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm.

Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje **Prof.Dr. Mirela Lika (Çekani)**, dhe **Prof.Asoc. Rezarta Kalaja**. Gjatë vizitës në institucion, ky grup pune u asistua edhe nga Koordinatorja Teknike e ASCAL, **Msc. Majlinda Demirneli**.

Pas një kohe në dispozicion të ekspertëve për të studiuar dokumentat dhe për të përpiluar pyetjet apo paqartësitë e tyre, u përcaktua edhe axhenda e vizitës në institucion, e cila u zhvillua në datat 19 dhe 20 Tetor 2023 në ambientet e KU "REALD". Gjatë vizitës ekspertëve iu vendos në dispozicion një sallë mbledhjesh për të kryer të gjitha takimet sipas axhendës së planifikuar. Dokumentacioni shtesë i kërkuar nga ekspertët pas vizitës në Institucion u vu në dispozicion në sistemin e informacionit të ASCAL datën 26.10.2023.

Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit dhe intervistave me pyetje të përcaktuara të ekspertëve, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas standardeve dhe për çdo kriter që i referohet standardit për programin e studimit Bachelor në "Higjenist Dentar".

Në fund paraqiten rekomandimet për institucionin dhe një analizë e pikave të forta dhe të dobëta të këtij programi studimi. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.

Kolegji Universitar "REALD" është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 01.12.2023, përmes sistemit AMS si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 141/41 Prot, datë 01.12.2023. Kolegji Universitar "REALD" më datë 02.12.2023, njofton nëpërmjet sistemit AMS, që është dakort me vlerësimin dhe nuk kanë komente mbi draft raportin. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Higjenist Dentar”

### I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Në vitin 2011, krijohet, Akademia e studimeve të aplikuara “REALD”, Licensuar me VKM Nr. 650; <b>riorganizuar</b>, në 2017 në Kolegjiin Universitar “REALD”, Urdhër MAS Nr. 147. (Ev. 3, Statuti)</p> <p>KUR ka hartuar strategjinë e zhvillimit (Ev. 3), dhe në përputhje me të synon të punojë në nivel lokal, rajonal e global për përhapjen e dijeve dhe konsolidimin e vlerave akademike, kulturore e kombëtare në fushën e stomatologjisë. Zhvillimet multidisiplinare janë prioritet strategjike për të garantuar karrierë profesionale konkurruese në tregun global në kuadrin e higjenistit dentar, dhe gjithnjë mbetet i orientuar të njihet në shkallë rajonale, evropiane dhe më gjerë.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Stafi i KUR, ka hartuar dhe ofron në përputhje me qëllimet dhe misionin e tij, programin e studimit të ciklit te pare Bachelor “Higjenist dentar”. Nga dokumentacioni në dispozicion: (Ev. 2, Ev. 4, Ev. 5, Ev. 6), vihet re se ky program ofrohet në fushën e veprimtarisë së tij.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Higjenist dentar” ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Mjeksores, Kolegji Universitar “REALD”. Programi është hartuar në përputhje me misionin e institucionit dhe fushën e veprimtarisë, ashtu siç sanksionohet edhe në Strategjinë e Zhvillimit DBK (Ev. 3). Programi synon të krijojë, transmetojë, zhvillojë dhe të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve (Ev. 2). Programi i studimit përmban elementët e domosdoshëm për të përmbushur misionin dhe për të realizuar objektivat për formimin e thelluar teorik – praktik të specialistëve në “Higjenist dentar”. (Ev. 47)</p>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së	<p>Institucioni ka ndërtuar strategjinë e zhvillimit, së fundmi për periudhën 2021 – 2026 (Ev. 3), që synon së pari të plotësojë aspiratat e studentëve, të sigurojë arsim të lartë cilësor, të zhvillojë partneritet të qëndrueshëm, ku shprehet se synimi</p>



<p>Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>strategjik i mësimdhënies është ngritja cilësore e mësimdhënies dhe përfshirja e stafit akademik dhe studentëve në punë kërkimore. Programi i studimit është hartuar në përputhje me statutin e KUR (Ev. 2) dhe zhvillohet në përputhje me rregulloren e studimeve (Ev. 6). Gjithashtu Departamenti synon ngritjen e cilësisë të diplomave në tregun e punës. DS bën përpjekje për të krijuar një mjedis dinamik ku gërshetohet tradita me kërkesat e aktualitetit dhe zhvillohet në përshtatje dhe zbatim të strategjisë për zhvillim të institucionit, e cila u evidentua nga GVJ gjatë takimeve me stafin akademik dhe autoritetet drejtuese, si dhe në vizitat e ambienteve të laboratorëve</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Pas konsultimit të dokumentacionit të dorëzuar, takimit në institucion dhe vizitës në ambientet e auditorëve dhe laboratorëve, GVJ konstaton se institucioni ka përvojë në ofrimin e programeve të studimit në fushën e Stomatologjisë.</p> <p>Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore i cili përbëhet nga 4 departamente:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Farmacisë;</li> <li>2. Departamenti i Stomatologjisë;</li> <li>3. Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore;</li> <li>4. Departamenti i Veterinarisë;</li> </ol> <p>Departamenti i Stomatologjisë është përgjegjës për programin e studimit Bachelor në “Higjienist dentar”. Institucioni ka përvojën dhe kapacitetet akademike për të përmbushur të gjitha objektivat e programit të studimit. Stafit akademik i përfshirë në këtë program studimi përbëhet nga personel në fushën e stomatologjisë. (CV e personelit akademik).</p> <p>GVJ u njoh me infrastrukturën mësimore që disponon institucioni, KUR, si dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Departamentin e Stomatologjisë, ku zhvillohet ky program studimi. Për zhvillimin e programit mësimor institucioni ka në dispozicion të studentëve salla për leksione dhe seminare të paisura me videoprojektorë, laboratorët e shkencave të natyrës, si dhe poltrona e laborator stomatologjik, etj. (Ev. 94, Ev. 95, vizita në institucion). Në dispozicion të studentëve janë dhe ambientet e bibliotekës. GVJ vizitoi ambientet e bibliotekës dhe u informua për rregulloren e funksionimit, listën e librave etj, gjatë takimit me punonjësit dhe përmes shqyrtimit të dokumentave në dosjen e programit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e</p>	<p>Programi është hartuar në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit të sistemit arsimor gjithëpërfshirës dhe i bazuar në</p>




<p>programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>parimet e barazisë dhe mësimi gjatë gjithë jetës (<b>Ev. 3 Strategjia zhvillimit institucional i KUR</b>)</p> <p>Ky program është hartuar në përputhje me ligjin e Arsimit të Lartë në Shqipëri, dhe si pjesë e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA) dhe Procesit të Bolonjës nga viti 2003.</p> <p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Shkencave Mjekësore. Ky Fakultet ka katër departamente dhe ofron disa programe studimi. Departamenti i Stomatologjisë është përgjegjës për programin Bachelor në Higjenist dentar (<b>Ev. 6, Neni 5</b>). Institucioni deklaron se ofron Bachelor në Higjenist dentar në gjuhën italiane në vitin 2020, (<b>Ev. 6, neni 5</b>). Programi i studimit Bachelor në “Higjenist dentar” ofrohet si program me kohë të plotë. Përsa i përket kodifikimit nuk gjejmë dokument që të identifikohet.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ gjykon se ky kriter përmbushet plotësisht pasi Programi studimit nuk bie ndesh me interesat kombëtare, ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, si edhe të Statutit dhe Rregullores. Institucioni ka demonstruar se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike të Programin e studimit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi I.2</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së</p>	<p>Për realizimin e programit të studimit Bachelor në “Higjenist dentar”, Departamenti i Stomatologjisë përfshin dhe struktura bashkëpunuese, si departamentet e tjera të FSHM, njësitë administrative, laboratorët, sekretaria (<b>Ev. 5, Ev. 6</b>). Organizimi i strukturave realizuese të programit dhe funksionimi i tyre është në përputhje me rregulloret dhe aktet e tjera të KUR (<b>Ev. 4</b>)</p>






<p>përgjegjësi përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>GVJ u njoh me dokumentacionin e gjerë të vënë në dispozicion mbi aktet rregullatore për ndarjen e detyrave dhe funksionimin e personelit akademik, administrativ dhe ndihmës në funksion të programit të studimit (Ev. 5, Ev. 6, Ev. 46, Ev. 48).</p> <p>Njesia baze bën analizë të vazhdueshme të punës mësimore dhe kërkimore të dokumentuar në raportet përkatëse të FSHM (Ev. 61). Në Departament funksionon dhe Komisioni për vlerësimin e brendshëm të ciësisë (grupi i RVB) i cili në përputhje me rregulloren e DS kryen detyra të përcaktuara qartë. KUR ka ngritur dhe NJSBC e cila jep kontribut në analizën e vazhdueshme të punës përmes grumbullimit dhe analizimit të informacionit si dhe përpunimit dhe krahasimit statistikor të të dhënave në bazë të indikatorëve Europianë (Ev. 37). Në takimin me stafin, pedagogët referuan që janë të përfshirë në procedurat vlerësuese e përmirësuese të syllabuseve, si dhe në hartimin e aplikimin e projekteve kërkimore shkencore. <b>(takimet në institucion)</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të programit Bachelor në “Higjenist dentar” institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe universitare brenda vendit, (Ev. 24, Ev. 25).</p> <p>Përmes këtyre marrëveshjeve institucioni ka mundësuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Realizimin e praktikës për studentët;</li> <li>- Realizimin e temave të diplomave;</li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Studentët e programit Higjenist dentar realizojnë praktika, si pjesë të programit mësimor dhe për këtë Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Klinika dentare ne Vlore, Spitalin Rajonal te Vlores, Spitalin Rajonal te Fierit, Spitalin Psikiatrik te Vlores (Ev. 26, Ev. 27, Ev. 28). Praktikrat mësimore, laboratorike zhvillohen duke shfrytëzuar infrastrukturën laboratorike të vetë institucionit <b>(Takimi me Dekanin dhe vizita në Institucion).</b></p> <p><i>GVJ i sugjeron institucionit të zgjerojë bashkëpunimin dhe me institucione të tjera private apo publike, si mundësi për të mbështetur dhe zgjeruar kapacitetet për realizimin e praktikave mësimore.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga</p>	<p>GVB deklaroi se Departamenti i Stomatologjisë harton raporte analitike mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit, raporte të cilat janë pjesë e analizës së punës mësimore kërkimore hartuar nga</p>




marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Përgjegjësi i Departamentit (Ev. 61). GVJ konstaton se raportet e analizës mësimore dhe kërkimore janë në nivel të njësisë baze.  <i>GVJ sugjeron që DS të përgatisë raporte mbi impaktin e bashkëpunimit me institucione të ndryshme në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit, në funksion të realizimit të programit të studimit.</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Ky standard përmbushet plotësisht, Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me IAL të tjera publike dhe private, kombëtare dhe ndërkombëtare. Njësia kryesore analizon punën mësimore dhe shkencore në mënyrë periodike, DS duhet të hartojë raporte analitike mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri I.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe	Programi i studimit Bachelor “Higjenist dentar” është ndërtuar në përputhje dhe në harmoni me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për arsimin e lartë në Shqipëri. Programi është i organizuar në lëndë, module dhe vlerësohet me kredite sipas Sistemit European të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) në përputhje me statutin e universitetit (Ev. 2). Referuar rregullores së studimeve në KUR (Ev. 4, Ev. 5), si dhe në rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në “Higjenist dentar” (Ev. 6).

<p>Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Bsc në Higjenist dentar është program i ciklit të parë të studimeve; korrespondon me Nivelin 6 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve;</li> <li>- Studime me kohë të plotë;</li> <li>- Kohëzgjatja e studimeve 3 vite akademike/6 semestra;</li> <li>- Programi i studimit është organizuar në lëndë/module sipas kriterëve ligjore në fuqi: ligji i arsimit të lartë 80/2015 dhe VKM nr.41, të MASR datë 24.01.2018;</li> <li>- Vlerësimi në kredite: 180 ECTS / 60 ECTS për vit akademik / 4500 orë total;</li> <li>- 1 ECTS = 25 orë mësimore dhe punë e pavarur e studentit;</li> <li>- Raporti ECTS: orë është 1 ECTS = 25 orë (Raporti 1/1.5 orë në auditor/orë studimi individual). Kohëzgjatja e orëve të mësimi është 50 minuta;</li> <li>- Frekuentimi i orëve të seminareve është i detyrueshëm në masën 75%, i leksioneve në mënyrë fakultative, si dhe 100% për orët e laboratorëve dhe praktikave;</li> <li>- Viti akademik ka 30 javë (secili semester ka 15 javë);</li> <li>- Viti akademik ka 4 sezone provimi: i dimrit-pas përfundimit të semestrit të parë, i verës-pas përfundimit të semestrit të dytë, i paradiplomimit-për studentët e vitit të tretë, i vjeshtës-pas pushimeve verore;</li> </ul> <p>Programi i studimit mbyllet me provim. Kjo reflektohet korektësisht edhe në regjistrin e sekretarisë mësimore (<b>Vizita në institucion</b>). Në rregulloren e programit të studimit (<b>Ev. 6, Ev. 7</b>) shkruhet Departamenti Stomatologjisë përcakton dhe miraton fushat përkatës, e mbi të cilat do të hartohet programi i mbrotjes së diplomës”.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose</p>	<p>Programi i studimit synon formimin e specialistëve kompetentë për të përmbushur nevojat dhe kërkesat e profesionit në mjediset akademike dhe profesionale dhe t'i paisë me kompetencat e duhura për zgjidhjen e problematikave të ndryshme. Programi i pajis studentët me njohuri të përgjithshme dhe specifike teorike dhe praktike për të përballuar sfidat e tregut të punës në fushën e higjenistit dentar. Programi synon dhe krijimin e shprehive të veçanta në specialitete të aferta (<b>Ev. 48, Ev. 49 plani mësimor</b>).</p> <p>Programi i studimit ka një ndërthurje harmonike të koncepteve teorike me praktikën në auditor dhe praktikën. Përmes kësaj</p>




<p>profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>ndërthurjeje, programi zhvillon tek studentët aftësi dhe kompetenca profesionale të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse në fushën e higjenes dentar. Formimi i përgjithshëm dhe aftësimi në laboratorët e institucionit krijon premisa edhe për profilizim profesional në fusha më specifike, i cili është dhe drejtimi i studimit në Masterin Shkencor (Ev. 48, Ev. 49, Ev. 97), (syllabuset, planet mësimore, vizita në ambientet e laboratorëve).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Referuar planit mësimor (Ev. 48) në Bachelor në “Higjenist dentar”, GVJ vlerëson se programi përmban të gjithë elementët sipas strukturës së përcaktuar në VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Sipas planit mësimor, programi i studimit përbëhet nga veprimtari formuese, të cilat realizohen me kredite ECTS dhe janë të grupuara në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Kategoria A: Lëndë bazë 31 ECTS (17 %);</li> <li>– Kategoria B: Lëndë karakterizuese 93 ECTS (51.67%);</li> <li>– Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese 23 ECTS (13%);</li> <li>– Kategoria D: Lëndë plotësuese 27 ECTS (15%);</li> <li>– Kategoria E: Detyrime përmbyllëse 6 ECTS (3.33%);</li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi i Studimit Higjenist dentar ka të përcaktuar ngarkesën prej 24 ECTS të praktikave profesionale gjate 3 viteve (Ev. 48). Praktikave profesionale zhvillohen në vitin e parë, të dytë dhe të tretë. Në Rregulloren Programit të Studimit (Ev. 6), detyrimet përmbyllëse përcaktohen me provim formimi apo me temë diplome. GVJ gjatë vizitës në institucion u informua se detyrimet përmbyllëse realizohen kryesisht me diplomë.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Sipas dokumentit të propozimit për hapjen e programit të studimit dhe sipas rregullores së funksionit të programit të cilat u shqyrtuan nga GVJ, ky program është hapur në përputhje me kërkesat ligjore të Ligjit për Arsimin e Lartë 80/2015. KU “Reald”, nuk gëzon status të veçantë, pra kjo pjesë e këtij kriteri nuk zbatohet për këtë institucion.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë</p>	<p>Institucioni deklaron se programi i studimit Bachelor në “Higjenist dentar” është në masën 70% i ngjashëm në</p>

studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	përmbajtje me programet me të njëjtën emërtesë që ofrohen nga Universiteti i Mjekësisë së Tiranës.			
<b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	GVJ gjeti kodin e programit të studimit (Ev. 49), dhe për rrjedhojë kodifikimin e lëndëve të programit.			
<b>Kriteri 8.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi i studimit nuk ofrohet në bashkëpunim me IAL të tjera vendase apo të huaja.			
<b>Konkluzione</b>	<i>Ky kriter përmbushet plotësisht. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, sipas kategorive të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore dhe ka të përcaktuar qartë ngarkesat respective në ECTS. Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën në ECTS të praktikave profesionale. Programi i studimit nuk ofrohet në bashkëpunim me IAL të tjera vendase apo të huaja. Ka kodin e programit të studimit dhe lëndëve të programit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.2</b>	
<b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin	Fakulteti i Shkencave Mjekësore që ofron programin e studimit Bachelor në "Higjienist dentar" përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. KUR është organizuar bazuar në ligjin Nr. 80/2015, date 22.07.2015 "Për Arsimin e lartë dhe

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

*Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Statutin e institucionit dhe zhvillon aktivitetin e tij në selinë në Shkodër.*

Fakulteti i Shkencave Mjekësore dhe Departamenti i Stomatologjisë pranë Kolegjit Universitar “REALD” janë të organizuara bazuar në kërkesat e legjislacionit në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike.

Njësia kryesore (FSHM) është e përbërë nga 4 njësi bazë:

1. Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore,
2. Departamenti i Farmacisë,
3. **Departamenti i Stomatologjisë,**
4. Departamenti i Veterinarisë.

Fakulteti i Shkencave Mjekësore, si Njësia Kryesore për programin e studimit për vitin akademik 2022-2023 ka gjithsej 61 pedagogë, nga të cilët 48 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 13 pedagogë me kontratë (PAK), me kualifikimin e mëposhtëm:

Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Shkencave Mjekësore	
	PAE	PAK
Prof.Dr	3	1
Prof.Asoc	-	2
Dr/PhD	18	6
Msc	27	4
<b>Gjithsej</b>	<b>48</b>	<b>13</b>

***Tabelat permbledhese per Aneks\_RVB 2023 - Higjenist Dentar.***


Departamenti i Stomatologjisë, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë për vitet akademike:

Tituj/ grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	1	0	1	-	-	-
Prof. Asoc.	-	-	-	-	-	-
Dr./PhD.	2	5	3	4	4	5
Msc.	8	1	5	1	10	1
<b>Totali</b>	<b>11</b>	<b>6</b>	<b>9</b>	<b>5</b>	<b>14</b>	<b>6</b>



	Vihet re që shumica e personelit akademik janë pa grada dhe tituj.			
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Për realizimin e programeve të studimit të Departamentit të Stomatologjisë, Bachelor në Higjienist dentar, angazhohet personeli akademik dhe stafi i ftuar për realizimin e praktikave profesionale. Njësia bazë me Urdhër nr. 1 datë 20.01.2023 “Për caktimin e personelit akademik që do të realizojë praktikat mësimore, laboratorike e klinike, në programin e studimit Bachelor në “Higjienist Dentar” përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar 3 personel për çdo vit akademik.  (Ev. 48, Ev. 51, Ev. 55, Ev. 76).			
<b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Personi përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij është përgjegjësi i Departamentit (RVB, Ev. 61). Departamenti përcakton personelin për programin e studimit, praktikat profesionale dhe labororet, për çdo vit akademik.  (Ev. 47, Ev. 76)			
<b>Konkluzione</b>	<i>Fakulteti i Shkencave Mjekësore që ofron programin e studimit Bachelor në “Higjienist dentar” përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. Institucioni përcakton një koordinatör për çdo vit akademik për programin e studimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën	Fakulteti i Shkencave Mjekësore në KUR që ofron programin e studimit Bachelor në “Higjienist dentar” zotëron gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Në dosjen e programit që gjendet informacioni për institucionin dhe për strukturën e programit të studimit, informacion për strukturën akademike




dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	përgjegjëse dhe strukturat bashkëpunuese, kuadri i përgjithshëm formues i programit, të dhënat për personelin akademik për realizimin e programit, plani mësimor, infrastruktura në dispozicion të programit, kriteret e pranimit, rregullorja e programit, syllabuset e lëndëve dhe suplementi i diplomës. <b>(dosja e programit të studimit)</b>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Në tabelat e planit mësimor të detajuar (EV. 49, Ev. 56)) jepet informacion për ndarjen e ngarkesës mësimore në vite akademike dhe semestra. Për secilën lëndë jepet informacion për kreditet, totalin e orëve dhe ndarjen e tyre në orë në auditor/orë studimi individual, si dhe për ndarjen e orëve në auditor në leksione, seminare, ushtrime, laboratorë, projekte dhe praktika. Në rregulloren e programit (Ev. 6) të studimit dhe në syllabuset e lëndëve përcaktohen kushtet e frekuentimit të mësimi (jo më pak se 75% e orëve totale për procesin mësimor që zhvillohet në auditor (praktikat, pasi leksionet janë fakultative) dhe në masën 100% për praktikat laboratorike dhe praktikën profesionale) si dhe skema e vlerësimit të dijeve. Në rregulloren e programit të studimit, theksohet se kontrolli i dijeve bëhet në dy pjesë: vlerësimi i vazhduar dhe vlerësimi në provim. Vlerësimi i vazhduar përcaktohet nga çdo pedagog, dhe miratohet nga Departamenti.
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Në takimet me studentët, GVJ konstatoi se institucioni vë në dispozicion të studentëve informacionin e plotë dhe të përditësuar për kriteret e pranimit, transferimit (Ev. 41, Ev. 42, Ev. 43) dhe transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve (Ev. 58, Ev. 59). Institucioni aplikon kriteret specifike të pranimit që vendosen me VKM dhe rregulloren e KUR (Ev. 4).
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi i studimit Bachelor në “Higjenist dentar” përmban syllabuset e detajuara për secilën lëndë (nr. 9). Syllabuset janë formatuar në përputhje të plotë me kërkesat e VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”.  Syllabuset janë të firmosura nga titullari i lëndës. Bien në sy fakti që <b>titullarët e disa lëndëve nuk janë të kategorisë Profesor</b> (kërkesë e ligjit të arsimit të lartë). Në syllabuse gjendet i detajuar informacioni për tipologjinë e lëndës, kreditet, shpërndarjen e orëve në auditor, vitin dhe semestrin në të cilin zhvillohet lënda. Syllabusi jep informacion për lëndën, objektivat dhe rezultatet e pritshme. Temat, literatura referuese dhe format e mësimdhënies janë detajuar sipas javëve. Çdo



	syllabus ka informacion për frekuentimin dhe mënyrën e kontrollit të dijeve. Në syllabuse është specifikuar literatura bazë dhe literatura e rekomanduar ( <b>paketat e syllabuseve</b> ). <i>GVJ rekomandon që titullarët e lëndëve/moduleve të jenë të kategorisë profesor.</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion se programi e studimit Bachelor në Higjenist dentar, KUR janë në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. GVB deklaron se ky përmirësim kryhet sipas procedurave të përcaktuara qartë, por nuk mbështetet me dokumentacion përkatës ku të tregohen ndryshimet e propozuara dhe masa e ndryshimit të kryer, kjo dhe për faktin që vetëm tri (3) vite ka.			
<b>Konkluzione</b>	<i>Ky standard përmbushet kryesisht. FSHM dhe Departamenti i Stomatologjise japin informacion mbi organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimit. Programi i studimit përmban informacion të detajuar mbi ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore, orët brenda dhe jashtë auditorit. Në rregulloren e programit të studimit jepen kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Syllabuset janë të plota në të gjithë elementët e planit mësimor. <i>GVJ rekomandon që titullarët e moduleve duhet t'i përkasin kategorisë "Profesor".</i></i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi II.4</b>	
<b>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi i studimit synon përgatitjen e specialistëve të aftë për të përballuar sfidat e tregut lokal të punës, si dhe krijon premisa për ekuivalentim të programit në tregun rajonal e më gjerë si dhe për kualifikim në programe të niveleve më të larta. Praktikave profesionale, si dhe praktikave mësimore i bëjnë studentët të aftë për manipulim dhe punë të pavarur në fushën e stomatologjise. Gjatë vizitës në ambientet e KUR, GVJ u njoh me politikën e institucionit për t'i vënë këto hapësira në

	funkcion të mësimdhënies dhe praktikave profesionale. (Ev. 95, Ev. 97, vizita në institucion)
<b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Programi ka një shpërndarje të llogjikshme të lëndëve në vite dhe semestra, si dhe vlerësim në kredite sipas rëndësisë së syllabusit në arritjen e objektivave formuese të programit të studimit. Organizmi dhe zhvillimi i programit mësimor, shpërndarja e ngarkesës në orë mësimore /ECTS ju mundëson studentëve arritjen e objektivave të programit, marrjen e rezultateve dhe fitimin e aftësive dhe kompetencës të nevojshme. Në planin mësimor vërehet një shpërndarje e harmonizuar e ECTS midis lëndëve të ndryshme duke mundësuar një formim të përgjithshëm në fushën e stomatologjise si dhe formim shkencor. Në program janë përfshirë dhe lëndë të një formimi të përgjithshëm organizativ dhe të komunikimit (gjuhë e huaj, njohuri kompjuteri etj) të cilat e aftësojnë studentin edhe në fushën e organizimit, kontrollit dhe dokumentimit të aktivitetit profesional. (Ev. 49, nr. 9 - syllabuset)
<b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Programi i studimit Bachelor në “Higjienist dentar” është strukturuar dhe përmirësuar bazuar në eksperiencën e gjatë të ofrimit të këtij programi nga KUR, si dhe mbështetur në modelet dhe praktikatat më të mira të institucioneve partnere të arsimit të lartë. Struktura e programit, emërtimi, raporti teori-praktikë janë në përputhje me profilin e profesionit dhe me programet europiane. (Ev. 48, Ev. 49) Në takimin me zyrën e kerkimit, GVJ u informua se KUR ka një sërë marrëveshje me universitete të huaja që mundësojnë mobilitetet e stafit dhe studentëve (Ev. 30, Ev. 31, Ev. 59).
<b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Strukturimi i programit (Ev. 48), unifikimi i termave të programit me programet europiane i bën studentët konkurues në tregun e punës publik e privat, mundësojnë transferimin e studimeve, si dhe mobilitetet e studentëve (Ev. 30, Ev. 31). GVJ nuk arriti të marrë informacion mbi nivelin e punësimit të të diplomuarve në këtë program studimi. Në takimin me përfaqësues të zyrës, GVJ u informua se institucioni bën përpjekje për gjurmimin e të diplomuarve, përmes kontaktimit me anë të telefonatave, apo email-eve, por ne kete rast ishte viti i pare qe kish mbaruar brezi i pare.
<b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në	Institucioni inkurajon përditësimin e vazhdueshëm të programit të lëndëve me literaturë të detyruar dhe ndihmëse, e cila pasqyrohet në syllabuset e moduleve (syllabuset). Një pjesë e pedagogëve synojnë dhe realizojnë hartimin e leksioneve të shkruara universitare për studentët e KUR (takimi me stafin




<p>përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p><b>akademik</b>). Në syllabuse është punuar për përditësimin e literaturës së huaj e ndihmuar dhe nga rikonceptimi i funksionimit të bibliotekës. Mbështetur në literaturë bashkëkohore, pedagogët e këtij programi studimi përgatisin leksione dhe materiale didaktike të shkruara për studentët.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>GVB deklaron se përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave në fushën e studimit Bachelor në "Higjenist dentar". Strukturimi i programit krijon mundësi për transferim të studimeve dhe mobilitet. (Ev. 30, Ev. 31). Objektivat e çdo programi studimi të ofruar nga Departamenti i Stomatologjise, paraqiten në analizën e punës mësimore kërkimore (Ev. 61), por këto janë dokumenta që shfrytëzohen nga një grup i kufizuar, prandaj <u>GVJ sugjeron që në rregulloren e e programit të studimit të citohen objektivat formuese, si dhe kompetencat që synohen të arrihen përmes këtij programi studimi.</u></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi i studimit është strukturuar dhe përmirësuar nga stafi akademik. Përmbajtja e programit të studimit u mundëson studentëve vijimin e studimeve në ciklin e parë. Departamenti i stomatologjise ofron dhe programin e studimit Master për Higjenist dentar dhe Bachelor dhe Master Shkencor në Stomatologji. (Ev. 46, Ev. 48). Në takimet në institucion u informuam se studentët që mbarojnë këtë program studimi preferojnë të vijojnë studimet Master në "Higjenist dentar" ofruar nga vetë KUR (<b>takimi me studentët</b>).</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Ky standard përmbushet kryesisht, Përmbajtja e programit të studimit, organizimi, shpërndarja e lëndëve mundësojnë studimet të mëtejshme në KUR, ose në universitete të tjera të vendit, si dhe punësimin e studentëve; Programi i studimit ofron mundësi për transferimin e studimeve, si dhe për mobilitetet e studentëve; Syllabuset përditësohen në mënyrë të vazhduar nga staf akademik; <u>GVJ sugjeron gjurmimin më të hollësishëm të të diplomuarve</u></i></p> <p><i>Në rregulloren e programit të studimit duhet të citohen objektivat formuese të programit të studimit, si dhe kompetencat që synohen të arrihen përmes këtij programi studimi.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	




<b>Standardi II.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	GVB deklaron se personeli akademik i përshtat syllabuset në përputhje me kërkesat e tregut. Gjatë vizitës në institucion ( <b>takimi me stafin, takimi me përfaqësues të zyrave</b> ), GVJ nuk i dhanë shembuj konkretë se si realizohet përmirësimi i programeve të studimit përmes konsultimit me grupet e ndryshme të interesit, siç mund të jenë të diplomuarit, kjo në fakt është dhe për faktin që sapo ka mbaruar brezi i parë.  <i>GVJ sugjeron konsultime me grupet e ndryshme të interesit, si institucionet partnere, të diplomuarit etj, për të përmirësuar programin e studimit në përputhje me kërkesat e tregut.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Institucioni ka në strukturën e tij Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI, e cila ndjek ecurinë e punësimit të studentëve të diplomuar në KUR, por edhe mbedh mendime për përmirësimin e programit.
<b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	GVJ nuk konstatoi hartimin e raporteve periodike mbi përfitimet e arritura nga marrëveshjet e bashkëpunimit. Përveç marrëveshjeve të bashkëpunimit, GVJ konstatoi bashkëpunime të Departamentit të stomatologjisë me rrjete profesionistësh, shoqata etj, të cilët kontribuojnë në përmirësimin dhe përditësimin e programit të studimit.
<b>Konkluzione</b>	<i>Ky standard përmbushet kryesisht. GVJ sugjeron konsultime me grupet e ndryshme të interesit, për të përmirësuar programin e studimit në përputhje me kërkesat e tregut, krahas nxitjes në përfshirjen e studentëve për këto përmirësime.</i>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b></p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Për zhvillimin e procesit mësimor, institucioni ka parashikuar përdorimin e metodave të ndryshme në transmetimin e dijeve si leksione, seminare, praktika profesionale, përgatitjen e detyrave të kursit, provim formimi, punë kërkimore në laborator, si dhe leksione të hapura siç është rasti i “Tetori roze”, “Mbrojtja jetes dhe shendetit” (Ev. 87, Ev. 89). Institucioni inkurajon gjithashtu pjesëmarrjen e studentëve në konferenca dhe seminare (takimi me stafin akademik), si p.sh., Konferenca Oral Implantology; seminari Implantology (Ev. 84, Ev. 85). Vlerësimi i dijeve është i kombinuar midis atij të vazhduar dhe vlerësimit përfundimtar.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë mësimdhënies përdoren metoda alternative si prezantime në ppt., biseda interaktive me studentët, demonstrimi i procedurave praktike laboratorike, ushtrime, vëzhgime në mikroskop. Studentët punojnë në grupe të vogla në laborator. Stafii akademik ndihmon studentët për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që dalin gjatë zhvillimit të mësimin apo laboratorëve mësimore. Në takimin me stafin akademik, GVJ konstatoi se pedagogu ka liri akademike në zhvillimin e orës së leksionit; inkurajohet mësimi interaktiv, debati etj (takimi dhe vizita në institucion). DS eksperimenton dhe implementon forma inovative dhe ndërdisiplinore, sic është përdorimi i paketës Microsoft Office, MS Teams etj. (Ev. 17; Ev. 18)</p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Institucioni ka siguruar infrastrukturën mësimore, e cila bën të mundur përdorimin e metodave pedagogjike fleksible të përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e pritshme të tyre në funksion të formimit të tyre profesional teorik. Në funksion të procesit mësimor dhe aktivitetit kërkimor janë laboratorët mësimorë dhe shkencorë (Ev. 94; Ev. 95).</p> <p>Institucioni mbështet pedagogët për përmirësimin e aftësive dhe kompetencave profesionale dhe metodave të mësimdhënies, nëpërmjet mbështetjes për pjesëmarrje në konferenca shkencore, aktivitete trainuese, përgatitje të projekteve, përfshirjen e tyre në marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike apo jo publike. <b>(takimet dhe vizita në institucion)</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit të student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka përgatitje profesionale, ekspertizën e duhur dhe eksperiencë pedagogjike në lëndët që zhvillon. Institucioni ka të siguruar logjistikën e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor, praktikave, aktivitetin kërkimor të studentëve etj. <b>(CV e stafit akademik, vizita në institucion)</b>. Staf i akademik inkurajon punën e pavarur të studentëve përmes prezantimit të projekteve, detyrave të kursit, pjesëmarrjes aktive të tyre në seancat laboratorike, praktikave mësimore dhe në terren.</p> <p>Personeli akademik është aftësuar dhe ka realizuar me sukses dhe metodat e inovative të mësimdhënies, si dhe përdorimin e platformave online si MS Teams etj.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Institucioni vlerëson në mënyrë periodike stafin akademik, procesin e mësimdhënies duke përfshirë në këtë proces edhe studentët nëpërmjet plotësimit të pyetësori të vlerësimit.</p> <p>Në KUR funksionon edhe Këshilli Studentor, i cili ka përfaqësuesit e tij në Senat, por gjithashtu është një aktor i rëndësishëm për ngritjen e zërit të studentëve në lidhje me kërkesat e tyre. KUR dhe Këshilli Studentor bashkëpunojnë dhe në mënyrë periodike përmes pyetësorëve, vlerësojnë programet mësimore dhe metodat e mësimdhënies, si dhe ti reflektojnë ato në përmirësimin e metodologjisë. <b>(Ev. 91)</b>.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që</p>	<p>Për ta bërë pjesën teorike të lëndëve sa më tërheqëse për studentin stafi akademik përdor metoda të ndryshme mësimdhënie, si me anë të projektorëve, prezantime PPT,</p>




<p>promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>metoda interaktive, metodat online duke shfrytëzuar platformat që janë të përdorshme si për studentët dhe pedagogët, përfshirjen e tyre në trainime dhe konferenca shkencore, apo projekte së bashku me pedagogët e tyre. KUR realizon trainimin e vazhduar të stafit akademik me metodat bashkëkohore të mësimdhënies. <b>(Takim ne institucion).</b> Gjithashtu, KUR nxit mobilitetet dhe shkëmbimin e stafit akademik në kuadër të bashkëpunimeve në marreveshjet e bashkëpunimit ndërkombëtare <b>(Ev. 24).</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Ky standard permbushet plotësisht. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve përfshijnë leksione, seminare, punë laboratorike, praktika në terren etj. Stafit akademik përdor forma alternative dhe inovative të mësimdhënies dhe për këtë gëzon mbështetjen e plotë të institucionit. KUR organizon trainime të vazhdueshme, duke i mundësuar stafit, trainimin me metodat bashkëkohore të mësimdhënies, të cilën GVJ e konsideron si praktikë të mire.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi III.2</b></p>	
<p><b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri I.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Institucioni zotëron gjithë bazën e nevojshme ligjore që rregullon organizimin e provimeve dhe vlerësimin e njohurive të studentëve të cilat bëhen publike dhe njihen nga studentët që në fillim të vitit akademik dhe u vihet këtyre të fundit në dispozicion. Në rregulloren e programit të studimit dhe në rregulloret e studimeve të KUR (Ev. 4; Ev. 6) përcaktohen në mënyrë specifike të gjitha rregullat dhe modalitetet e testimit të njohurive. Në syllabuset e lëndëve pasqyrohen format e kontrollit të njohurive.</p>




<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Studentët informohen në fillim të vitit akademik nga titullari i lëndës/modulit mbi metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore. Metodologjia e vlerësimit përshkruhet dhe në syllabuset e lëndëve/moduleve dhe rregulloren e studimeve të KUR, në rregulloren e programit të studimit. Vlerësimi bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe provimi përfundimtar.</p> <p><b>(Ev. 49, syllabuset)</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme. Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm janë: provimet, detyrat e kursit dhe niveli i aktivizimit në seminare/laboratore, si dhe provimi i diplomimit. Vlerësimi i vazhdueshëm i jep mundësi studentit të demonstrojë më mirë njohuritë dhe kompetencat e fituara. Provimi bëhet me shkrim, me gojë ose i kombinuar sipas specifikës së programit të lëndës. <b>(Ev. 6. Rregullore e programit të studimit; Ev. 49 syllabuset)</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Stafi akademik përmirëson metodat e mësimdhënies duke marrë në konsideratë dhe opinionet dhe sugjerimet e studentëve. Njësia bazë në bashkëpunim me NJSBC, kryejnë anketime me studentët, gjetjet e të cilit përdoren për përmirësimin e cilësisë dhe larmisë së metodave të mësimdhënies. <b>(Ev. 91)</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Institucioni ka siguruar infrastrukturën mësimore e cila bën të mundur përdorimin e metodave pedagogjike fleksible të përshtatshme me temat e lëndëve dhe në funksion të formimit të tyre profesional teorik. Në funksion të procesit mësimor dhe aktivitetit kërkimor janë laboratorët e ndryshëm të përmendur dhe më sipër. KUR i kushton një vëmendje të veçantë punës praktike të studentëve, përmes eksperimenteve laboratorike, por edhe praktikave në terren. Gjatë procesit mësimor dhe praktikës në terren studentët asistohen nga pedagogët, si dhe stafi ndihmës akademik i kualifikuar. Motoja e institucionit është “mësojmë duke bërë”. Institucioni mbështet pedagogët për përmirësimin e aftësive dhe kompetencave profesionale dhe metodave të mësimdhënies, nëpërmjet mbështetjes për pjesmarje në konferenca shkencore, aktivitete trainuese, përgatitje të projekteve, përfshirjen e tyre në marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike apo jo publike. <b>(takimet</b></p>



	<b>dhe vizita në institucion dokumentacioni për mobilitetin e pedagogëve).</b>		
<b>Konkluzione</b>	<i>Ky kriter përmbushet plotësisht. Kriteret dhe vlerësimi i njohurive të studentëve bëhet në përputhje me rregulloret e ndryshme të cilat bëhen publike dhe të njohura për studentët. Testimi bëhet në forma të ndryshme në përputhje me rregulloren. Për të përmirësuar format dhe metodat e mësimdhënies, stafi akademik merr në konsideratë sugjerimet e studentëve.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

### Standardi III.3

**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet qartë sistemi i vlerësimit të njohurive dhe aftësive profesionale (Ev. 6). Në këtë rregullore theksohet se kontrolli i dijeve bëhet në mënyrë të vazhdueshme. Kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet testimeve me shkrim dhe me gojë, detyrave të kursit, punës në grup, praktikave profesionale dhe provimit përfundimtar.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	KUR ka në zbatim mënyra të ndryshme për të shmangur forma të ndryshme abuzimi dhe për të rritur transparencën. Institucioni ka sistem elektronik testimi dhe vlerësimi për testin e hyrjes së studentëve në programin e studimit. Gjithashtu, gjatë pandemisë, institucioni ka përdorur testimin on-line. Ku testi ju dërgohej në formë linku, dhe studenti e plotësonte nën mbikqyrje të komisionit të provimit on-line. Për testimin e lëndëve, provimet kryhen në salla të mbikqyrura nga kamera, që redukton mundësinë e kopjimit, dhe rezultatet jepen brenda 3 ditëve nga kryeja e provimit.
<b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet nga pedagogu lektor, nën mbikqyrjen e titullarit të lëndës, dhe teza e përgatitur prej tij firmoset nga Drejtuesi i Departamentit. Përmbajtja e tezës bazohet në syllabusin e lëndës të dhënë gjatë viti akademik, dhe




	përban gjithë elementët informues të kërkuara nga baza ligjore në fuqi. (Ev. 7; Ev. 8).
<b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Studenti hyn në provim pasi ka kryer detyrimet e procesit mësimor për çdo lëndë dhe detyrimet finaciare sipas detyrimeve që ka me institucionin. Në rregulloret e institucionit njihet e drejta e studentit për t'u njohur me rezultatin e provimit, madje dhe për tu ankimuar.  (Ev. 63, Ev. 64, Takimi me studentët)
<b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Njësitë përgjegjëse bëjnë përpjekje për të luftuar plagjiaturën dhe kopjimin në provime (Ev. 7; Ev. 8). GVJ konstaton se në rregulloren e studimeve të KUR dhe të Programit të studimit "Higjienist dentar", nuk konsiderohet fenomeni i plagjiaturës, si dhe masat që duhet të merren për ta luftuar atë. Në institucion funksionon Kodi i Etikës, që plagjiaturën apo format e tjera të vjedhjes intelektuale (Ev. 13) i konsideron shkelje të rregullave të etikës.  <i>GVJ i sugjeron institucionit të rishikojë rregulloret, ku të tregohen mënyrat dhe mjetet që duhet të përdoren për shmangien e plagjiaturës, si dhe masat disiplinore që duhet të merren në raste të tilla.</i>
<b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Testimi i dijeve bëhet me shkrim, me gojë, ose i kombinuar. Në rregulloren e KUR përcaktohet afati 7 ditë për shpalljen e rezultateve të provimit, përmes postës elektronike, ose përmes një date të caktuar nga pedagogu i lëndës. (Ev. 4, neni 58).
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studentët kanë të drejtën e ankimit të rezultatit nëse kanë pakënaqësi, apo paqartësi të lidhura me vlerësimin. Kjo e drejtë sanksionohet në rregulloret e institucionit dhe të programit të studimit. Këto rregullore i japin të drejtë studentit të njihet me vlerësimin, të ankimohet për vlerësimin, të mund të përmirësojë notën përmes riprovimit.  (Rregullore e studimeve në KUR, Ev. 4, neni 59, pika 4; Takimi me studentët).
<b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e	Studentët që kanë ankesa, në ditën e marrjes së rezultatit mund të bëjnë kërkesë me shkrim pranë dekanit të fakultetit përkatës për rivlerësim, kërkesë e cila i dërgohet departamentit përkatës. Departamenti krijon një komision <i>ad hoc</i> , për rivlerësimin e studentit dhe vë në dijeni pedagogun e lëndës. Pas këtij afati,

ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	<p>proçesi i vlerësimit të provimit quhet i përfunduar dhe gjenerohet proçesverbali dhe askush nuk ka të drejte të ndërhyjë më në sistem për ndryshim rezultatesh.</p> <p><b>(Rregullore e studimeve KUR, Ev. 4, neni 59; Ev. 5; Ev.7; Ev. 8).</b></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Ky standard permbushet plotesisht. Vlerësimi i njohurive bëhet në mënyrë të vazhduar, ashtu siç saknsionohet në rregulloret e KUR. Vlerësimi u bëhet i ditur studentëve sipas afateve kohore të përcaktuara në rregullore, duke u njohur të drejtën që ata kanë për tu ankimuar. Institucioni konsideron plagjiaturën, apo kopjen në provime si shkelje të etikës, por në rregulloret rrespektive nuk parashikohen mënyrat e shmangies së këtyre fenomeneve, si dhe masat disiplinore, që duhet të merren në raste të tilla</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit është hartuar në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin dhe rritjen e njohurive për formimin e specialistëve në fushën e higjenistit dentar (EV. 48). Misioni dhe qëllimi i programit të studimit janë formimi i specialistëve të aftë në fushën e higjenistit dentar, përmes integritit të teorisë me praktikën në laborator dhe klinika. Studentët marrin formim bazë në lëndët shkencore, si dhe formim bazë dhe të avancuar në shkencat dhe metodologjitë në fushat e higjenes dhe stomatologjisë. Volumi që zënë orët e laboratorëve dhe praktikës profesionale u jep mundësi studentëve të zhvillojnë aftësitë e tyre profesionale dhe të praktikohen gjatë manipulimeve dhe punës së pavarur (Ev. 49).
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane,	Programi mësimor krahas lëndëve të formimit bazë dhe lëndëve të formimit profesional përmban dhe lëndë të formimit të përgjithshëm si gjuha e huaj, apo lëndët që kanë të bëjnë me etiken, statistiken, psikologjinë, etj. Këto lëndë kontribuojnë për të shtuar aftësitë komunikuese dhe ndërvepruese, për

<p>sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>formimin jo vetëm si profesionist por dhe qytetar. (Ev. 48, Ev. 49)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmblyllëse.</p>	<p>Cdo titullar lënde ka përcaktuar në syllabusin e lëndës kompetencat dhe aftësitë që do të fitojë në përfundim të lëndës. Pedagogu i lëndës, gjatë zhvillimit të leksioneve, seminareve, praktikave mësimore, orienton studentët për çështjet më të rëndësishme, si dhe detyrimet përmblyllëse që ai ka kundrejt plotësimit të programit. Detyrimet e studentit janë: pjesmarrja në leksione, seminare, praktika, kryerja e detyrave të kursit, provimeve. Plotësimi i detyrimeve, bën të mundur që studenti të fitojë kompetencat dhe aftësitë përkatëse në përfundim të lëndës. Në përfundim të lëndës, analizohen nga pedagogu kompetencat dhe aftësitë e fituara, të cilat pasqyrohen në relacionet personale të pedagogut, më tej në Departament, ku bëhet analizë e detajuar (Ev. 49, nr 9).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Në programin Bachelor në “Higjienist dentar” janë angazhuar pedagogë me përvojë në mësimdhënie. Bazuar në CV e stafit akademik, fusha e ekspertizës së pedagogut përputhet me syllabusin e lëndës të cilën zhvillon pedagogu duke ndikuar në cilësinë e mësimdhënies. (CV e stafit akademik, takimet në institucion).</p> <p>Një ndër mënyrat që motivon studentët në përvetësimin e programit mësimor është dhe puna e pavarur e studentit, puna në grup, apo puna kërkimore në laboratorët e vetë DS. Vlen të përmendim Laboratorin stomatologjik. Studentët në seancat e praktikave profesionale, si dhe gjatë seminareve fitojnë aftësi praktike, komunikuese mjaft të mira (Ev. 95).</p> <p>Në ambientet e laboratorëve mësimorë procesi praktik është punë në grup dhe në ndonjë rast edhe demonstrativ. Stafit akademik inkurajon edukimin e punës në grup për zgjidhjen e problemeve. Stafit akademik gjithashtu mundohet të kontribuojë në zgjidhjen e nevojave të ndryshme, zgjidhjen e problematikave të cilat janë pjesë e mbledhjeve të departamentit. Departamenti organizon veprimtari të karakterit mësimor edhe shkencor (Ev. 83) KUR bën përpjekje për të rritur mobilitetet e studentëve, por nuk kemi evidence për këtë.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë</p>	<p>Personeli akademik efektiv dhe i ftuar realizon orë të hapura e seminare mbi zhvillimet e reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit. Departamenti organizon aktivitete të ndryshme të karakterit mësimor dhe shkencor, ku mund të përmendim konferencat si Oral Implantation; The implantology seminar; Mbrojtja e jetes dhe</p>

brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	shendetit; seminari: Sustainable Cooperation Between Italian and Albanian Academic Conyexts. Eëhich instruments fromEU.		
<b>Konkluzione</b>	<i>Ky standard plotesohet plotesisht. Programi i studimit garanton thellimin e njohurive teorike dhe praktike, dhe zhvillon aftësitë profesionale të studentëve. Këto aftësi e kompetenca që fitohen nga studenti analizohen në fund të lendës nga Pedagogu e më tej nga Departamenti. Staf i akademik i përfshirë në procesin mësimor zhvillon orë të hapura mbi zhvillimet më të reja të teknologjisë brenda strukturës së programitInstitucioni bën përpjekje për të realizuar mobilitete të studentëve në universitete të huaja, kryesisht italiane, por duhet të rritet numri i studentëve Bachelor që përfshihen në mobilitete të tilla.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Programi i studimit Bachelor “Higjenist dentar”, sipas rregullores së programit të studimit mund mbyllet me provim të përgjithshëm përfundimtar dhe/ose punim diplome. Gjatë vizitës në Instutcion GVJ, u informua se programi i studimit realisht mbyllet me provim formimi per mesatare nen noten 8, ndersa mbi kete note mbrohet me diplome. Në rregulloren programit të studimit (Ev. 48, Ev. 65, <b>Diplomimi</b> ) mbi procedurën e diplomimit ku përcaktohen kushtet që duhet të përmbushë studentit para diplomimit <i>Studenti në përfundim të kursit të plotë të studimeve, për të fituar të gjitha kreditet e parashikuara në planin mësimor i nënshtrohet procesit të diplomimit për të fituar titullin sipas emërimit të diplomës. Diplomimi bëhet pasi të jetë plotësuar dhe dorëzuar në sekretarinë mësimore dokumentacioni i paracaktuar në këtë rregullore. Institucioni shpall datat e diplomimit dhe i bën ato publike edhe në faqen ëeb të KUR.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në	Strukturat përgjegjëse informojnë studentët mbi dokumentacionin e detyrueshëm. Staf i akademik mbështet studentët, duke vënë në dispozicion programin e provimit të formimit, fondin e pyetjeve etj. Në rregulloren e programit të

dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	studimit (Ev. 6; Ev. 20) përcaktohen qartazi përbërja e komisionit të provimit të formimit, përgatitja e tezave dhe mënyra e realizimit të provimit.
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Provimi realizohet përpara një komisioni të posaçëm, të përbërë nga pedagogë titullar të fushave që mbulon programi i provimit. Anëtarët e komisionit propozohen nga përgjegjësi i departamentit. Modalitetet e diplomes jane ne Ev. 8, Rregullore e diplomimit, Neni 20, Neni 21.
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Rregullorja e programit të studimit Ev. 4, Neni 64 përshkruan qartësisht dhe hollësisht procedurën e mbrojtjes me punim diplome. <b>(takimi me stafin, takimi me studentët).</b>
<b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	KUR ka siguruar infrastrukturën, si dhe kapacitetet njerëzore të përshtatshme për realizimin e programit të studimit. Stafi akademik ndihmon studentët për kryerjen e matjeve, praktikave në seancat laboratorike, apo praktikat profesionale. <b>(Ev. 20; vizita në institucion)</b>
<b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.	Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me note <b>(rregullore e programit të studimit, Ev. 6; Ev. 4)</b>
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria	Studenti që ka përfunduar studimet, pajiset me diplomën përkatëse, të shoqëruar me suplementin e diplomës. Diploma është sipas formatit të miratuar nga Ministria përgjegjëse për arsimin dhe nënshkruhet nga Rektori. Në fund të studimeve,




përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit (Ev. 48; Ev. 65; Ev. 66; Ev. 67)			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Sekretaria mësimore ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit në 2 gjuhë: italisht dhe shqip; si dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen (Ev. 98; Ev. 99).			
<b>Konkluzione</b>	<i>Ky standard plotësohet plotësisht. Në rregulloren e programit të studimit specifikohen procedurat e provimit të përgjithshëm përfundimtar ose punimit të diplomës. Në rregullore përcaktohet pragu 8 për studentët që mund të realizojnë punim diplome. Megjithatë studentët i mbyllin studimet e tyre me një provim formimi, i cili realizohet në të njëjtën mënyrë si dhe provimet e tjera të lendëve. Stafi akademik mbështet studentët mbi kryerjen e matjeve apo analizave gjatë punëve laboratorike, praktikave mësimore dhe profesionale. Studenti në përfundim të studimeve paiset me suplementin e diplomës, sipas formatit të miratuar nga MASR, si dhe me kopje të plotë zyrtare të programit të studimit. Dokumentacioni i studentit ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe i vihet në dispozicion rast pas rasti, sipas kërkesave.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

##### Standardi IV.1



**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																		
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, rezulton se institucioni ka përvojën dhe kapacitetet akademike për të përmbushur të gjitha objektivat e programit të studimit. Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore i cili përbëhet nga 4 departamente:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Departamenti i Farmacisë;</li> <li>• Departamenti i Stomatologjisë;</li> <li>• Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore ;</li> <li>• Departamenti i Veterinarisë;</li> </ul> <p>Departamenti i Stomatologjisë është përgjegjës për programin e studimit Bachelor në “Higjenist dentar”. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, i angazhuar në realizimin e programit të studimit, kanë formimin e duhur profesional dhe përmbushin kërkesat ligjore në fuqi. Stafi akademik i përfshirë në këtë program studimi përbëhet nga personel në fushën e stomatologjisë. (Ev. 51. CV e personelit akademik).</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbas vizitës në institucion, (Tabelat permblledhese per Aneks_RVB 2023 - Higjenist Dentar, tab 6.1-6.3). stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi për tre vite akademike është si më poshtë vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Për vitin akademik 2020- 2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 11 pedagogë nga të cilët 7 PAE dhe 4 PAK (63 % /37 %);</li> <li>2. Për vitin akademik 2021- 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 15 pedagogë nga të cilët 10 PAE dhe 5 PAK (66 % / 34 %);</li> <li>3. Për vitin akademik 2022- 2023 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 18 pedagogë nga të cilët 11 PAE dhe 7 PAK (61 % / 39 %);</li> </ol> <table border="1" data-bbox="608 1675 1347 1942"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Tituj/grada</th> <th colspan="2">2020 - 2021</th> <th colspan="2">2021 - 2022</th> <th colspan="2">2022 - 2023</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE:</th> <th>PAK:</th> <th>PAE:</th> <th>PAK:</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof.As.Dr</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>-</td> <td>4</td> <td>1</td> <td>5</td> <td>2</td> <td>6</td> </tr> </tbody> </table>	Tituj/grada	2020 - 2021		2021 - 2022		2022 - 2023		PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:	Prof.Dr	-	-	-	-	-	-	Prof.As.Dr	-	-	-	-	-	-	Dr/PhD	-	4	1	5	2	6
Tituj/grada	2020 - 2021		2021 - 2022		2022 - 2023																														
	PAE	PAK	PAE:	PAK:	PAE:	PAK:																													
Prof.Dr	-	-	-	-	-	-																													
Prof.As.Dr	-	-	-	-	-	-																													
Dr/PhD	-	4	1	5	2	6																													



	Msc	7	-	9	-	9	1																				
	Në total	7	4	10	5	11	7																				
	<p>Koordinatori i programit të studimit zotëron aftësitë profesionale dhe eksperiencën praktike të nevojshme, për të përmbushur funksionet e tij.</p> <p><i>Rekomandojmë që koordinatori i programit të studimit të jetë staf akademik efektiv.</i></p> <p><b>(Ev. 2 në dokumenta shtesë. Urdhëri i emërimit të koordinatorit të programit të studimit.)</b></p>																										
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me komizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Për realizimin e programit Bachelor në “Higjenist dentar”, janë angazhuar staf akademik efektiv dhe me kontratë që zotërojnë grada shkencore apo Msc. Në dokumentacionin e vënë në dispozicion të GVJ, është paraqitur lista e stafit akademik të përfshirë në realizimin e programit mësimor në këtë program studimi, si dhe formimi i tyre profesional, për tre vitet akademike 2020-2023.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacion mbi Planit mësimor dhe CV të stafit akademik, GVJ konstaton se formimi profesional i pedagogëve përputhet lënda që ata zhvillojnë në programin e studimit. Referuar (Ev. 56.) u konstatua se ngarkesa mësimore e personelit akademik për tre vite akademike është si më poshtë vijon:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti</th> <th>Total orësh</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE/PAK (%)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2020-2021</td> <td>720</td> <td>552</td> <td>168</td> <td>77% / 23 %</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>1440</td> <td>1248</td> <td>192</td> <td>86% / 14%</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>2088</td> <td>1848</td> <td>240</td> <td>89% / 11%</td> </tr> </tbody> </table> <p>Nga sa më sipër rezulton që për të tre vitet akademike, ngarkesa mësimore për këtë program studimi, është përballuar me mbi 70% nga stafi akademik me kohë të plotë, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017.</p>							Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	2020-2021	720	552	168	77% / 23 %	2021-2022	1440	1248	192	86% / 14%	2022-2023	2088	1848	240	89% / 11%
Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)																							
2020-2021	720	552	168	77% / 23 %																							
2021-2022	1440	1248	192	86% / 14%																							
2022-2023	2088	1848	240	89% / 11%																							
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Departamentit ku zhvillohet programi i studimit, si dhe CV e stafit akademik konstaton se në tre vitet e fundit stafi akademik është stabil. GVJ evidenton se gjatë këtyre viteve PAE është rritur në numër dhe cilësi, ndërsa në</p>																										

<p>periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>PAK ndryshimet janë të mëdha në vitin 2022-2023 ku vërehet shtim të stafit akademik efektiv dhe ulje të PAK. Nga shqyrtimi me sondazh i kontratave të punës konstatojmë se janë paguar rregullisht sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. (Ev. 68; Ev. 69).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në Zyrën e Burimeve Njerëzore të institucionit, GVJ u njoh me procedurat e rekrutimit të stafit, me modelet e kontratave të punës për PAE, PAK dhe pedagogë të ri me kontratë. GVJ verifikoi me sondazh dosjet e personelit akademik, kontratat e punës të stafit akademik efektiv dhe me kontratë dhe të stafit të ri akademik me kontratë. Institucioni disponon rregullore të veçantë në lidhje me kriteret e kandidatëve dhe procedurën e rekrutimit të miratuar nga Kolegji Universitar REALD. Procedura e rekrutimit të personelit akademik me kohë të plotë apo të pjesëshme realizohet nga njësia bazë duke propozuar komisione Ad-hoc konform bazës ligjore dhe nën ligjore si dhe akteve të brendshme rregullatore të KUR. Procedurat e rekrutimit të personelit janë transparente, në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në statutin dhe rregulloren e institucionit. Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik, procedura u verifikua nga dokumentacioni që na u vu në dispozicion dhe nga takimet e realizuara me titullarët. Vlerësimi i kandidatëve bëhet me sistem pikëzimi. Nga shqyrtimi me sondazh i dosjeve të personelit GVJ konstatoi se është i pranishëm dokumentacioni i kërkuar. Rekrutimi i stafit kryhet sipas akteve rregullatore të miratuar nga KUR dhe në kodin e punës. Në diskutimin me pedagogët u konstatua se ata njihen paraprakisht me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga lidhja e kontratës së punës. Bazuar në statusin e KUR dhe kodin e punës Institucioni ka hartuar procedura e kriteret për rekrutimin e personelit. (Ev. 70; Ev. 10; Ev. 2; Ev. 4).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion dhe në dokumentacion, evidentohet angazhimi i personelit ndihmës akademik, të cilët asistojnë dhe realizojnë orët laboratorike dhe gjithashtu realizojnë mirëmbajtjen e laboratorëve mësimorë. Personeli ndihmës akademik është i mjaftueshëm dhe ka kompetencën dhe angazhimin e duhur për realizimin e detyrave të tij. (Ev. 56).</p>

<p>specifike të programit të studimit.</p>	
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion në sistem GVJ konstatoi se KUR, disponon një bazë të dhënash për anëtarët e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të përfshirë në programin e studimit Bachelor në “Higjenist dentar”. Kjo bazë të dhënash gjendet pranë zyrës së Burimeve Njerëzore ku disponohen dosjet personale të stafit akademik e cila mban dhe marrëveshjen për realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për çdo semestër, si dhe dosjen personale për staf jo akademik.</p> <p>Çdo vit Zyra e burimeve Njerëzore bën dhe përditësime në bazën elektronike të të dhënave dhe dokumentacionit plotësues përkatës. Institucioni ka vënë në dispozicion listën e personelit akademik efektiv dhe me kontratë, ngarkesën e tyre mësimore si dhe kualifikimet e tyre. Gjithashtu GVJ evidentoi që çdo fund viti akademik, pedagogët hartojnë, dorëzojnë dhe miratojnë pranë drejtuesit të departamentit evidencat e realizimit të ngarkesës mësimore për vitin akademik të mbyllur, proces pune ky i koordinuar nga Drejtuesi i Departamentit, Drejtorja e Kurrikulave dhe Standardeve të Cilësisë. Të dhënat përfshijnë listat e personelit të angazhuar për çdo semestër dhe vit akademik, në përputhje edhe me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p><b>(Ev. 14; Ev. 16; Ev. 2; Ev. 4; Ev. 5; Ev. 10).</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të programit Bachelor në “Higjenist dentar” institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe universitare brenda vendit. Përmes këtyre marrëveshjeve institucioni ka mundësuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Realizimin e praktikës për studentët</li> <li>– Realizimin e temave të diplomave</li> </ul> <p>Studentët e programit Higjenist dentar realizojnë praktika, si pjesë të programit mësimor dhe për këtë Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me një sërë klinikash të ndryshme dentare në Vlorë, Spitalin Rajonal të Vlores, Spitalin Rajonal të Fierit, Spitalin Psikiatrik të Vlorës.</p> <p>Praktikat mësimore, laboratorike zhvillohen duke shfrytëzuar infrastrukturën laboratorike të vetë institucionit <b>(Takimi me Dekanin dhe Përgjegjësën e Departamentit, Vizita në Institucion)</b>. Për kryerjen e orëve të praktikës mësimore dhe profesionale sipas programit të studimit KUR garanton</p>




	<p>mjedise të mjaftueshme dhe të mirëpajisura brënda institucionit si dhe jashtë tij, në institucione të shërbimit shëndetësor dentar privat dhe spitalor në zbatim të marrëveshjeve të bashkëpunimit që kanë nënshkruar me këto institucione. Marrëveshjet kanë si qëllim kryerjen dhe mbështetjen e praktikës profesionale si dhe realizimin e diplomës. Marrëveshjet janë të lidhura në nivel Instucional dhe zbatohen nga njësia bazë.</p> <p><b>(Ev. 24; Ev. 25; Ev. 26; Ev. 27; Ev. 28.)</b></p> <p><i>GVJ i sugjeron institucionit të zgjerojë bashkëpunimin dhe me institucione të tjera private apo publike, si mundësi për të mbështetur dhe zgjeruar kapacitetet për realizimin e praktikave mësimore.</i></p>
<p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritisë që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Institucioni ka një procedurë të përcaktuar për përcaktimin e udhëheqësve të praktikave profesionale që përzgjidhen nga personeli i institucioneve ku realizohet praktika klinike në bazë të marrëveshjeve të lidhura. Praktikant profesional të programit të studimit Bachelor në “Higjenist dentar” realizohen në KUR si dhe në një sërë klinikash dentare private, me të cilat IAL ka marrëveshje bashkëpunimi dhe janë të shpërndara sipas grafikut të organizuar nga lektori i praktikave në bashkëpunim me përfaqësuesin e institucionit ku zhvillohet praktika. Personeli mbikqyrës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në programin e studimit Bachelor në “Higjenist Dentar” ndihmon studentët në përmbushjen e detyrimeve, raportit përfundimtar të praktikës gjithashtu dhe në vlerësimin e tyre. Personeli dentar i cili ndjek praktikant profesional në klinikë, bashkëpunon ngushtë me stafin akademik të departamentit. Në përfundim të praktikës profesionale, studenti i nënshtrohet provimit të praktikës dhe vlerësohet me notë nga komisioni i cili e merr në provim.</p> <p><b>(Ev. 8; Ev. 20; Ev. 76)</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>-Për realizimin e programit të studimit Bachelor “Higjenist Dentar”, IAL ka angazhuar staf akademik efektiv dhe me kontratë që zotërojnë gradë shkencore apo Msc.</i></p> <p><i>- 82-86 % e ngarkesës mësimore realizohet nga stafi akademik efektiv.</i></p> <p><i>-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të Planit mësimor dhe Cv të stafit akademik, GVJ kostaton se formimi profesional i pedagogëve përputhet me lëndë që ata zhvillojnë në programin e studimit.</i></p>




	<p><i>-KUR, disponon një bazë të dhënash për anëtarët e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të përfshirë në programin e studimit Bachelor në "Higjenist dentar".</i></p> <p><i>-Për kryerjen e orëve të praktikës mësimore dhe profesionale sipas programit të studimit, KUR garanton mjedise të mjaftueshme dhe të pajisura mirë, brënda institucionit si dhe jashtë tij, në institucione të shërbimit shëndetësor dentar privat dhe spitalor, në zbatim të marrëveshjeve të bashkëpunimit që ka nënshkruar me këto institucione.</i></p> <p><i>GVJ i sugjeron institucionit të zgjerojë bashkëpunimin dhe me institucione të tjera private apo publike, si mundësi për të mbështetur dhe zgjeruar kapacitetet për realizimin e praktikave mësimore.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**Standardi IV.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri I.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh më mjediset e KUR. Infrastruktura, mjediset mësimore, teknologjia e informacionit, shërbimet për studentët janë të përshtatshme dhe në plotësim të standarteve për zhvillimin e një procesi cilësor mësimor. Kolegji Universitar REALD, zhvillon procesin mësimor në një godinë me kushte optimale për zhvillimin e këtij procesi, si dhe me kushtet e nevojshme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe lëndëve të formimit të përgjithshëm. Në dokumentacionin e dorëzuar përshkruhet infrastruktura e nevojshme, sipërfaqet, sallat e leksioneve dhe seminare, laboratorët mësimore, laboratorë të informatikës, ambientet ndihmëse çlodhëse në funksion të stafit dhe studentëve, zyra për stafin të mirëpajisura, bibliotekë si dhe hapësirë të jashtme. Auditorët kanë hapësira të mjaftueshme, të ndriçuara dhe me sistem ngrohje/ftohje. Njësia bazë ka në dispozicione mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore. Organizimi i orarit mësimor është bërë në përputhje me natyrën specifike të</p>

	<p>programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p> <p><b>(Ev. 94; Ev. 95)</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Ambientet e mësimdhënies janë të mjaftueshëm për realizimin e programit të studimit. Sallat e leksioneve dhe seminareve kanë numrin e mjaftueshëm të vendeve për studentët të cilët janë të organizuarar në grupe, në raport me numrin e vendeve në sallë. Ambientet mësimore janë me sistem kondicionimi ngrohje dhe ftohje. Ambientet e KUR kanë sistemin e mbrojtjes kundra zjarrit, të cilat u konstatuan dhe gjatë vizitës në institucion. GVJ vizitoi auditorët mësimorë, laboratorët dhe sallat e leksioneve dhe konstatoi se pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënien në përputhje me qëllimet e programit. Në funksionin të programit janë në dispozicion mjete elektronike audiovizive dhe të teknologjisë së informacionit, si kompjutera, ëhiteboard, videoprojektorë, kryesisht në sallat e leksioneve. Ndriçimi natyral dhe ai artificial ishte i bollshëm dhe i dedikuar për ambientet mësimore. Në dispozicion të personelit akademik dhe administrativ ekzistojnë ambiente të mjaftueshme për punë dhe studim. Në ambientet e fakultetit ku zhvillohet programi i studimit Bachelor në “Higjenist dentar”, gjenden laboratorët e lëndëve të formimit bazë, si dhe laboratorët e Stomatologjisë, në të cilët zhvillohen leksione të integruara me praktikën për studentët.</p> <p><b>(Vizita e ambienteve; Ev. 94; Ev. 95)</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion u konstatua se KUR zotëron laboratorë mësimorë modern, në funksion të programeve të studimit që zhvillohen në Departamentin e Stomatologjisë, apo departamente të tjera të FSHM. Laboratorët e stomatologjisë janë të ndarë në laboratorë paraklinik dhe klinik. Laboratorët paraklinik janë të pajisur me numrin e nevojshëm të mulazheve që simulojnë kavitetet orale të pacientëve, për të bërë më të lehtë kuptimin dhe fitimin e aftësive praktike të nevojshme. Laboratori klinik ka një sërë poltronash dentarë, të cilët zhfrytëzohen nga stafi akademik dhe stafi që ndjek praktikën mësimore për të shpjeguar dhe venë në praktikë, të gjitha procedurat klinike të nevojshme për një higjenist dentar. Mjediset janë të ndriçuara dhe të pajisura me kapacitete ngrohëse e ftohëse gjatë gjithë vitit. Ato janë gjithmonë funksionale dhe në dispozicion të studentëve. Në dispozicion të studentëve të programit të studimit Bachelor në “Higjenist Dentar”, janë edhe laboratorët e departamenteve të tjera si dhe biblioteka e cila është e pajisur me materiale mësimore dhe</p>






	libra të viteve të fundit, që përditësohen në mënyrë të vazhdueshme. <b>(Ev. 95; Ev. 97; Vizita e ambjenteve në IAL)</b>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Në funksion të programit të studimit Bachelor në “Higjenist dentar”, është laborator i Informatikës. Laboratori është i pajisur me kompjutera dhe programe profesionale që përdoren nga studentët pa pagesë për qëllim mësimi apo përgatitje të detyrave të kursit dhe/ose mikrotezës. Auditorët e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me videoprojektor dhe me mundësi për të aksesuar sistemin ëireless të internetit. <b>(Ev. 96)</b>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>-Infrastruktura, mjediset mësimore, teknologjia e informacionit, shërbimet për studentët janë të përshtatshme dhe në plotësim të standarteve për zhvillimin e një procesi cilësor mësimor.</i></p> <p><i>-KUR zotëron laboratorët mësimor në funksion të programeve të studimit që zhvillohen në Departamentin e Stomatologjisë apo departamante të tjera të FSHM, si dhe marrëveshje bashkëpunimi me institucione shëndetësore për realizimin praktikës profesionale.</i></p> <p><i>-Laboratorët e Stomatologjisë janë të ndarë në laboratorë paraklinik dhe klinik. Laboratorët paraklinik janë të pajisur me numrin e nevojshëm të mulazheve që simulojnë kavitetet orale të pacientëve, për të bërë më të lehtë kuptimin dhe fitimin e aftësive praktike të nevojshme. Laboratori klinik ka një sërë poltronash dentarë, të cilët zhfrytëzohen për të shpjeguar dhe venë në praktikë të gjitha procedurat klinike të nevojshme për një higjenist dentar.</i></p> <p><i>-Në funksion të programit të studimit Bachelor në “Higjenist dentar”, është laborator i Informatikës, i cili është i pajisur me kompjutera dhe programe profesionale për që përdoren nga studentët pa pagesë për qëllim mësimi apo përgatitje të detyrave të kursit dhe/ose mikrotezës.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi IV.3




**IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjediset e posaçme).**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni siguron tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse në gjuhën shqipe dhe Italiane, si dhe leksione të shkruara/ të printuara për programet e studimit. Biblioteka është e pajisur me vende interneti, me kompjutera që i mundësojnë studentëve dhe pedagogëve shfrytëzimin e literaturës së nevojshme për realizimin e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. GVJ nga shyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për këtë program studimi, si dhe nga vizita në Institucion vuri re se në bibliotekë janë gjithsej 2500 libra, kryesisht të marra vitin e fundit. Materialet janë si për të mbuluar pjesën e lëndëve bazë, ashtu edhe për ato të lëndëve profesionale. Pjesa më e madhe e librave të specialitetit, janë të vëna në dispozicion në bibliotekën online, ku gjenden libra në gjuhën italiane dhe shqipe.</p> <p><b>(Ev. 100; Ev. 101; Ev. 102).</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Gjatë takimeve me Stafin Drejtues, u deklarua që çdo fillim viti akademik, titullari i lëndës/ pedagogu dorëzon në njësinë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Higjienist dentar”, programet lëndore ku jepen detaje mbi literaturën e detyruar bazë dhe të rekomanduar e cila duhet të jetë e përditësuar me botime bashkëkohore. Gjatë vizitës në bibliotekë GVJ evidentoi një numër të lartë të titujve, por literatura mjeksore profesionale nuk ishte shumë e pasur me libra fizikë. Pjesa më e madhe e materialeve gjëndeshin online. I njëjti fenomeni evidentua gjatë gjatë shqyrtimit të syllabuseve, GVJ evidentoi që literatura e detyruar dhe e rekomanduar në syllabuse është e vjetëruar dhe në një pjesë të konsiderueshme të lëndëve bazohet në leksionet e shkruara nga vetë pedagogët. Në takimin me stafin akademik u theksua se çdo vit akademik paraqiten kërkesa për tekste dhe literaturë mjekësore dhe parashikohen fonde për blerjen e literaturës shkencore.</p> <p><i>GVJ rekomandon pasurimin e kësaj literature me libra të viteve të fundit, si dhe shtimin e literaturës fizike profesionale.</i></p> <p><b>(Syllabuset e lëndëve të programit të studimit)</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke</p>	<p>KUR ofron për studentët një bibliotekë me hapësira të dedikuara dhe të bollshme për studentët. Mjediset e bibliotekës kanë kapacitete në tituj dhe pajisje si kompjutera</p>






<p>garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>për të mundësuar plotësimin e kërkesave të tyre. Numri i titujve fizikë në fond është 2500, artikujt shkencorë mbi 160 dhe librat elektronikë mbi 2000. Ambientet e bibliotekës janë të hapura në çdo kohë dhe kanë mundësi shfrytëzimi në mënyrë të barabartë nga studentët.</p> <p><b>(Ev. 100; Ev. 101; Ev. 102; Vizita e ambienteve në institucion)</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës GVJ evidentoi që Biblioteka e KUR, është e pajisur me tekste universitare, libra e revista në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj. Ajo ka një fond fizik të literaturës mësimore bazë, literaturë ndihmëse, në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të huaja, libra elektronikë. Këto materiale mbulojnë pjesën më të madhe të moduleve dhe veprimtarive mësimore, të këtij programi studimi.</p> <p><i>Megjithatë GVJ rekomandon që literatura duhet të pasurohet më tej me botime të fundit dhe me tituj të rinj në fushën e shkencave mjekësore, si dhe të shtohen botimet e fundit profesionale.</i></p> <p><b>(Ev. 100; Ev. 101; Ev. 102; Vizita e ambienteve në institucion).</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka është në funksion të programit mësimor si për studentët dhe pedagogët. KUR ka krijuar kushte për shfrytëzim të barabartë dhe pa pagesë, si të bibliotekës fizike ashtu dhe asaj on-line. Kapacitet e bibliotekës ofrojnë kënde pune për punë në grup, kompjutera me mundësi aksesimi në internet. Të gjitha këto kapacitete mund të shfrytëzohen nga studentët e programit të studimit “Higjienist Dentar”, për të studiuar, realizuar detyrat dhe projektet e kursit apo prezantuar projektet e tyre. Nga ana tjetër të gjitha punimet, materialet didaktike, librat universitar duhet të depozitohen në bibliotekë, duke e pasuruar më shumë atë.</p> <p><b>(Ev. 100; Ev. 102; Vizita e ambienteve në institucion)</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka siguron literaturë fizike dhe digjitale/on line në ndihmë të studentëve dhe stafit akademik. Gjithashtu KUR, ka vënë në dispozicion përdorimin e librarive elektronike ku studentët mund të konsultohen me materiale në gjuhë të huaj. Biblioteka është e pajisur me programe të integruara bibliotekare. Biblioteka vë në dispozicion katalogun e saj elektronik, me standard ndërkombëtar i cili ofron një version të avancuar në kërkimin e informacionit si dhe falas në formatin elektronik artikuj, teza, kërkimin shkencor dhe disertacionet e</p>




	<p>stafit akademik të KUR-së.</p> <p><b>(Ev. 102; Vizita e ambienteve në institucion)</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka është në funksion të programit mësimor si për studentët dhe pedagogët. Gjatë vizitës në institucion, nga GVJ u identifikua se oraret e shërbimit të bibliotekës ishin të afishuara 08.00 – 16.00 për çdo ditë të javës, si dhe gjatë fundjavës, orare këto në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve. Institucioni ka punonjës të veçantë për bibliotekën të cilët përgjigjen për mirëmbajtjen e saj dhe përmbushjen e nevojave të studentëve.</p> <p><b>(Vizita e ambienteve në institucion)</b></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>KUR planifikon çdo vit buxhet të veçantë për pasurimin e fondit të bibliotekës me tituj të rinj apo përditësim të fondit ekzistues në funksion të programeve mësimore. Propozimet për titujt apo tekste vijnë nga departamentet e fakulteteve dhe përgatiten nga stafi i bibliotekës i cili përgatit listën e teksteve të kërkuara me buxhetin përkatës dhe dorëzon në rektorat.</p> <p>Në takimet me stafin akademik dhe në RVB theksohet se në çdo vit akademik parashikohen fonde për blerjen e literaturës shkencore, të cilat më pas parashikohen në buxhetin e Fakultetit. Lidhjet për aksesimin e bibliotekës on-line:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Libra për Mjekë: <a href="http://ëëë.freebooks4doctors.com/f.php?f=hiv">http://ëëë.freebooks4doctors.com/f.php?f=hiv</a></li> <li>- Botime për Mjekë: <a href="http://ëëë.freemedicaljournals.com/">http://ëëë.freemedicaljournals.com/</a></li> </ul> <p><b>(Ev 100; Ev. 101; Ev. 102; Vizita e ambienteve në institucion).</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>- KUR ofron për studentët një bibliotekë me hapësira të dedikuara dhe të bollshme për studentët.</p> <p>-Oraret e shërbimit të bibliotekës ofrohen sipas një kalendari të miratuar dhe të afishuar në ambientet e bibliotekës.</p> <p>-Institucioni siguron tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse në gjuhën shqipe dhe të huaj, leksione të shkruara/ të printuara për programet e studimit.</p> <p>-Për këtë program studimi literatura bazë për një pjesë të konsiderueshme të lëndëve janë leksione të shkruara nga pedagogu i lëndës.</p> <p>-Biblioteka në KUR siguron literaturë fizike dhe digjitale/on line ku studentët mund të konsultohen me materiale në gjuhë</p>

	<p>të huaj.</p> <p>-Biblioteka është e pajisur me programe të integruara bibliotekare. Biblioteka vë në dispozicion katalogun e saj elektronik, me standard ndërkombëtare i cili ofron një version të avancuar në kërkimin e informacion si dhe falas në formatin elektronik artikuj, teza, kërkimin shkencor dhe disertacionet e stafit akademik të KUR-së.</p> <p>-Pavarësisht numrit të lartë të titujve, literatura stomatologjike ishte e varfër në tituj të viteve të fundit.</p> <p><i>GVJ rekomandon pasurimin e kësaj literature me tekste dhe botime të viteve të fundit.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet kryesisht		Përmbushet plotësisht
		X	

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>KUR disponon sistem menaxhimi nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. Sekretaria mësimore dokumentacionin e ruan në dy forma: shkresore dhe elektronike (e implementuar më së fundmi – Sistemi SMI). Ajo është përgjegjëse për regjistrat, hedhjen e të dhënave dhe për marrëdhëniet me studentët. Ky sistem menaxhimi siguron ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit, akademike, prodhimin e raporteve statistikore si dhe menaxhimin e aspekteve të funksionimit të Kolegjit. Çdo student ka llogarinë e tij në këtë sistem ku në mënyrë konfidenciale mer informacion për rezultatet e provimeve, regjistrohet në lëndët që do të frekuentojë apo provimet që do të japë gjatë vitit akademik.</p> <p>Sekretaria mësimore ka në formë shkresore:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Regjistrin themeltar të studentëve;</li> <li>2. Regjistrin me të dhënat akademike;</li> <li>3. Regjistrin e lëshimit të diplomave;</li> </ol>

	<p>Rregjistrat ruhen pa afat dhe arkivohen në arkivën e shtetit. Sekretaria mësimore arkivon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Dosjet e regjistrimit të studentëve me gjithë dokumentacionin përkatës;</li> <li>- Proçesverbalet me rezultatet e provimeve të studentëve;</li> <li>- Dosjet e diplomimit - Dokumentacioni që verifikon plotësimin e kushteve për diploma, proçesverbalet e notave të provimit/temave të diplomës, listën e të diplomuarve përcjellë rektoratit për miratim, fotokopje të diplomave të tërhequra;</li> </ul> <p>Në sistem kanë akses pedagogët, studentët, sekretaria mësimore. Të gjitha opsionet e mundëshme janë të përcaktuara në rregulloren e përdorimit të sistemit SMI, nga secili prej përfitueve të tij, rregullore e hartuar nga Zyra e IT.</p> <p><b>(Ev. 14; Ev. 15; Ev. 16; Ev. 71; Ev.73; Ev.74)</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka dokumentacion të plotë lidhur me stafin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ të angazhuar në realizimin e programit mësimor. Menaxhimi i këtyre të dhënave realizohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore. Dosjet personale të stafit akademik PAE dhe PAK, ndihmës akademik dhe administrativ, CV, kontratat e punës proçedurat e punësimit, ruhen në arkivën e IAL.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion u verifikua se Institucioni ka sistem të brendshëm të menaxhimit të të dhënave dhe informacionit, i cili funksionon në bazë të rregullores përkatëse. Stafit akademik dhe studentët kanë akses për informacione apo dokumenta të nevojshëm në dobi të programit të studimit. Në sistemin SMI, në regjistrat e sekretarisë dhe në zyrat e sekretarisë së titullarit të njëjës kryesore (fakultetit) pasqyrohen, administrohen dhe ruhen të dhëna dhe informacione, dokumentacione të studentëve që ndjekin studimet, si dhe të dhëna të rezultateve gjatë viteve të studimit, të dhëna për personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, programet e studimit kurrikular, të dhëna financiare në lidhje me tarifën e studentëve dhe pagesat e kryera. Institucioni disponon sistemin e tij elektronik të të dhënave SMI dhe një rregullore të funksionimit të tij. Në këtë sistem kanë profilin e tyre dhe akses të gjithë studentët, stafit akademik efektiv dhe me</p>

	kontratë. Çdo student ka portofolin e tij elektronik, me akses personal, me të dhëna konfidenciale. (Ev. 15; Ev. 16)
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për studentët dhe pedagogët. Sic u theksua me lart, çdo student ka llogarinë e tij në këtë sistem ku në mënyrë konfidencialë merr informacion për rezultatet e provimeve gjatë vitit akademik në mënyrë konfidenciale. Sistemi SMI ka të përfshirë edhe komunikimin interaktiv dhe shkëmbimin e informacioneve. Një vend të rëndësishëm zë edhe shpërndarja e informacionit që lidhet me mbarëvajtjen e procesit mësimor. Ky informacion dokumentohet në “Këndin e njoftimeve” dhe ëeb-in e Universitetit me seksion të veçanta për fakultetin, departamentin apo edhe programin e studimit. IAL i siguron çdo studenti edhe postën elektronike: emër.mbiemër@unireald.edu.al. Si formë alternative e komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit me studentët, pedagogët dhe sekretarinë, përdoren faqet e KUR në facebook dhe instagram:</p> <p><a href="https://www.instagram.com/universiteti_reald/">https:// www.instagram.com/universiteti_reald/</a></p> <p><a href="https://www.facebook.com/universiteti_reald-1493359964292710">https:// www.facebook.com/universiteti_reald-1493359964292710</a></p> <p><b>(Vizita në institucion; Ev. 14; Ev. 15)</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Në sistemin e menaxhimit kanë llogari sekretaria mësimore dhe autoritetet drejtuese duke krijuar mundësinë e monitorimit në kohë reale të të gjitha të dhënave dhe mundësinë e gjenerimit të raporteve në lidhje me frekuentimin, rezultatet, etj. Kjo llogari mundëson pasqyrimin e aktivitetit akademik semestral dhe komunikimin midis stafit për problematikat që lindin nga pasqyrimi i vlerësimit në sistem.</p> <p><b>(Ev. 14; Vizita në institucion)</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Faqja zyrtare përmban informacion kryesor në lidhje me Kolegjin: misionin, drejtimin, funksionimin dhe organogramën. Faqja zyrtare jep informacion mbi fakultetet, kërkimin shkencor, shërbime të tjera që ofrohen nga KUR, programet mësimore që ofron çdo fakultet sipas departamenteve. Faqja zyrtare përmban informacion të plotë mbi aktivitetet e organizuara nga KUR, stafin akademik, programet dhe sylabuset e lëndëve, fakultetet, departamentet dhe programet mësimore që zhvillohen në secilin departament, orarin mësimor etj. Portali i KUR-së shërben si një platformë ku studenti mund të marrë informacion në ëbsit-et e pedagogeve për materiale të ndryshme në lidhje</p>




	<p>me lëndë specifike. Faqja zyrtare në ëeb është në 3 gjuhë, në gjuhën shqipe, italiane dhe atë angleze.</p> <p><a href="https://unireald.edu.al/en/homepage-4/">https://unireald.edu.al/en/homepage-4/</a></p> <p>Ëebsite i FSHM:</p> <p><a href="https://unireald.edu.al/it/fakulteti-i-shkencave-mjeksore/#fakulteti">https://unireald.edu.al/it/fakulteti-i-shkencave-mjeksore/#fakulteti</a></p> <p>Ëebsite i programit mësimor:</p> <p><a href="https://unireald.edu.al/programe/#bachelor-in-igiene-dentale">https://unireald.edu.al/programe/#bachelor-in-igiene-dentale</a></p>		
<b>Konkluzione</b>	<p><i>-KUR disponon sistem menaxhimi nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit, sistemin SMI.</i></p> <p><i>-Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për studentët dhe pedagogët, çdo student ka llogarinë e tij në këtë sistem ku në mënyrë konfidenciale merr informacion për rezultatet e provimeve gjatë vitit akademik. Në sistem kanë akses pedagogët, studentët, sekretaria mësimore.</i></p> <p><i>-Sistemi i menaxhimit të informacionit ka të integruar sistemin e brëndëshëm SMI ku hidhen, ruhen dhe përpunohen të dhëna në lidhje me vlerësimin e studentit.</i></p> <p><i>-Faqja zyrtare KUR përmban informacionet kryesore në lidhje me Kolegjin Universitar REALD: misionin, drejtimin, funksionimin, organogramën, etj.</i></p> <p><i>-Faqja zyrtare në ëeb është në tre gjuhë në gjuhën shqipe, italiane dhe angleze</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**






<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Çdo vit akademik KUR, harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit, për të paktën një cikël të plotë studimi. Hartimin e këtij plani e realizon Drejtoria e Financës së IAL dhe buxheti miratohet nga Bordi i Administrimit. Bordi i Administrimit miraton gjithashtu edhe një fond të veçantë për mbështetjen e aktiviteteve të studentëve, apo kërkimet shkencore të stafit. (Ev. 108)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Çdo vit akademik FSHM në bazë kërkesave dhe planifikimeve të Departamentit, harton buxhetin i cili miratohet nga Bordi i Administrimit. Pjesë e buxhetit janë tarifatat e shkollimit të studentëve. Institucioni harton dhe miraton tarifatat e shkollimit për çdo program bazuar në VKM 638, datë 22.07.2015. Buxheti përfshin pagat e stafit akademik dhe mbështetës, tarifatat e shkollimit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor apo shpenzime të tjera në funksion të realizimit të programit; investimet, kontratat e shërbimeve në funksion të programeve të studimit dhe aktivitete trajnuese. Njësia bazë njihet me raportin financiar të institucionit. Raporti financiar pasqyron në mënyrë tabelore informacion për të ardhurat financiare nga tarifatat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare për çdo vit akademik. Në fund të çdo viti, institucioni harton raportet financiare për realizimin e buxhetit si dhe përgatit buxhetin afat mesëm për funksionimin e institucionit dhe programeve të studimit. Hartimi i buxhetit mbështetet në kërkesat dhe planifikimi që bën çdo fakultet. (Ev. 108; Ev. 109)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Institucioni deklaron se kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Ky dokumentacion hartohet dhe administrohet nga Zyra e Financës së IAL. <i>GVJ nuk gjeti ndonjë raport auditimi.</i> (Ev. 109).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Në përfundim të vitit, Njësia bazë dhe ajo Kryesore njihet me raportin financiar të institucionit. Ato marrin informacion mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës dhe planifikimin e buxhetit për vitin pasardhës. Raporti financiar pasqyron në mënyrë tabelore informacionin për të ardhurat financiare nga tarifatat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare për</p>






	<p>çdo vit akademik. Në fund të çdo viti institucioni harton raportet financiare për realizimin e buxhetit si dhe përgatit buxhetin afat mesëm për funksionimin e institucionit dhe programeve të studimit. Hartimi i buxhetit mbështetet në kërkesat dhe planifikimin që bën çdo fakultet. (Ev. 108; Ev. 109)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Kolegji Universitar Reald, garanton qëndrueshmërinë financiare për realizimin e objektivave dhe misionit të tij bazuar në të ardhurat që siguron nga tarifat e shkollimit, dhe jo vetëm, si dhe deklaron se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në raste të krijimit të nevojave të caktuar, për të cilat planifikon ndërhyrje të posaçme në financimin e programit të studimit.</p> <p><b>(Ev. 108; Ev. 109)</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>-Çdo vit akademik KUR harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</i></p> <p><i>- Shpërndarja e fondeve bëhet në bazë të nevojave që paraqesin njësitë kryesore në bazë të kërkesave të planifikuara në cdo fillim viti akademik.</i></p> <p><i>-Çdo vit akademik FSHM në bazë kërkesave dhe planifikimeve të Departamentit, harton buxhetin i cili miratohet nga bordi i adminstrimit.</i></p> <p><i>- Në përfundim të vitit, Njësia bazë dhe ajo Kryesore njihet me raportin financiar të institucionit. Ato marrin informacion mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës dhe planifikimin e buxhetit për vitin pasardhës.</i></p> <p><i>-Universiteti garanton qëndrueshmërinë financiare për realizimin e objektivave dhe misionit të tij, bazuar në të ardhurat që siguron.</i></p> <p><i>Rekomandohet qe te kete nje ndarje me te mire per buxhetin ne baze te njesise baze.</i></p>

Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Kolegji Universitar REALD dhe Fakulteti i Shkencave Mjeksore, kanë hartuar Statutin dhe Rregullore në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto dokumenta janë shkruar qartë politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje. Këto procedura janë në përputhje të plotë me Satutin e KUR, rregulloret e FSHM, rregulloren e Departamentit të Stomatologjisë dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore. Në këtë dokumentacion përcaktohen procedurat e propozimit të kuotave të pranimit, procedurat e transferimit të studimeve dhe ndjekjes së programeve të dyta.</p> <p>Procedura e pranimit realizohet mbi bazën e kriterëve specifike të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit bachelor në “Higjenist Dentar”, si edhe sipas Udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve (MAS). Në rregulloren e departamentit dhe programit të studimit, studenti gjen informacion të plotë për strukturën e fakultetit, programet e studimeve që ofrohen, organizimin e programeve, diplomimin etj. Në funksion të informimit dhe ndjekjes së studentit nga regjistrimi në diplomim funksionon dhe sekretaria mësimore. Informacioni udhërrëfyes për studentët gjendet dhe në faqen ëeb të universitetit.</p> <p><b>(Ev. 4; Ev. 5; Ev.6)</b></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>FSHM ofron mundësi të barabarta për të gjithë studentët e programit të studimit. Studentët kanë mundësi të njëjta informimi, studimi, kandidimi për forume drejtuese, pjesmarrje në aktivitete promovuese, konkurimi për bursa apo mobilitete në kuadër të projekteve të ndryshme. Përzgjedhja realizohet me procedura transparente duke respektuar meritokracinë. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e studentëve janë përcaktuar në rregulloret përkatëse.</p> <p><b>(Ev. 4; Ev. 5)</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Para çdo viti akademik pas kërkesës së MAS, departamenti përcakton kriteret specifike dhe kuotat e pranimit të cilat të cilat miratohen në dekanat dhe aprovohen nga Senati akademik. Kuotat përcaktohen në bazë të kapaciteteve njerezore, akademike dhe ato logjistike. Senati akademik i dërgon kuotat dhe kriteret e pranimit në MAS. Kriteret dhe kuotat e pranimit publikohen në portalin e universitetit: <a href="https://unireald.edu.al/studentet/kriteret-e-pranimit">https://unireald.edu.al/studentet/kriteret-e-pranimit</a>.</p> <p>Në këto kritere përfshihen dhe parashikohen edhe regjistrimi i studentëve të huaj, karakteristikë kryesore kjo e KUR. Kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve janë të përcaktuar në rregulloren e Kolegjit Universitar REALD dhe Fakultetit të Shkencave Mjeksore. Institucioni bashkëpunon me RASH dhe QSHA për procedurat e regjistrimit dhe të transferimit të studentëve.</p> <p><b>(Ev. 41)</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Në rregulloren e departamentit, në statutin e KUR dhe në ëeb janë paraqitur qartë e në mënyrë të kuptueshme informacionet për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Organizimin e programeve të studimit;</li> <li>• Kriteret për pranimet në ciklin e parë dhe të dytë;</li> <li>• Procedurat e miratimit të kuotave dhe tarifave;</li> <li>• Ndërprerjen e studimeve, procedurat e transferimit apo të ndjekjes së një programi të dytë studimi;</li> <li>• Rregullat e ekuivalentimit etj;</li> </ul> <p>Rregullorja e departamentit, Rregullorja e programit të studimit dhe syllabuset kanë informacion të qartë e të detajuar për format e mësimdhënies, planin mësimor, mënyrën e kontrollit të dijeve, realizimin e praktikës dhe detyrave të kursit, procesin e diplomimit me provim/temë diplome.</p> <p>Informacioni për studentët është transparent dhe gjendet i</p>




	<p>publikuar dhe në faqen ëeb të KUR. Kriter i përgjithshëm i pranimit është nota mesatare e shkollës së mesme e përcaktuar me VKM. Diploma e arsimit të mesëm e marrë në një shtet të huaj duhet të njihet më parë nga struktura përkatëse në MAS.</p> <p>Në takimin me studentët GVJ konstatoi se studentët janë të kënaqur me aksesin në informacion, me funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës, me funksionimin e sekretarisë mësimore në ndihmë të tyre. Në statusin e KUR dhe Rregulloren e DS përcaktohen procedurat e përcaktimit të kuotave dhe tarifave për programin e studimit. Institucioni ka parashikuar dhe kuota për regjistrimin e studentëve nga trojet dhe shtresat e marginalizuara. Të gjithë informacionet e mësipërme gjënden të publikuara në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ëëbsite e KUR <a href="https://unireald.edu.al/studentet/">https://unireald.edu.al/studentet/</a></li> <li>• Facebook e KUR</li> <li>• Të afishuara në sekretarinë mësimore</li> </ul> <p><b>(Vizita në institucion; Ev. 4; Ev. 5; Ev. 6)</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>KUR ka në traditën e tij organizimin e ditëve të hapura informuese për publikun - Info Day, në të cilat, prindër dhe gjimnazistë nga gjimnazet e qarkut të Vlorës dhe të qarqeve fqinjë, të cilët janë të interesuar për programet e studimit që ofrohen nga kjo IAL, informohen nga pedagogë dhe studentë. Këto aktivitete organizohen zakonisht sipas një kalendari i cili rakordohet me Drejtoritë Rajonale të Arsimit, dhe kanë në fokus njohjen e të interesuarve me kriteret e përgjithshme dhe specifike për t'u pranuar në programet e studimit, mundësitë e shkollimit dhe punësimit pas mbarimit të programeve të studimit etj. Informacioni gjendet gjithashtu në faqen ëeb të KUR: <a href="https://unireald.edu.al/studentet/kriteret-e-pranimit">https://unireald.edu.al/studentet/kriteret-e-pranimit</a>.</p> <p><a href="https://ëëë.instagram.com/universiteti_reald/">https://ëëë.instagram.com/universiteti_reald/</a></p> <p><a href="https://ëëë.facebook.com/universiteti_reald-1493359964292710">https://ëëë.facebook.com/universiteti_reald-1493359964292710</a></p> <p><b>(Ev. 92)</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Para fillimit të çdo viti akademik KUR, parashikon kuota të caktuara dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Këto kriteret dhe kuota bëhen publike përpara fillimit të çdo viti akademik dhe publikohen edhe në ëëbsite-in e fakultetit.</p> <p><b>(Ev. 77)</b></p>




<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Pas diskutimit me drejtuesit e njësive kryesore dhe të njësive bazë, KUR harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera të cilët janë të interesuar për të ndjekur studimet. Këto kriteret janë përputhje me aktet nënligjore të MAS. Kuotat e pranimit llogariten mbi bazën e studentëve aktivë, që ndjekin programet e studimit. Ato bëhen publike nga IAL-të dhe i përcillen Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe Ministrisë përgjegjëse për arsimin. Programi i Studimit Bachelor “Higjenist Dentar”, duke qënë se zhvillohet në gjuhë huaj dhe pranon studentë të huaj (italianë), kërkon që aplikantët të plotësojnë kriteret si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Diplomë të shkollës së mesme/Maturës shtetërore, të njohur nga MAS;</li> <li>2. Të plotësojë kriterin e notës mesatare të shkollës së mesme sipas VKM;</li> <li>3. Të marrë vlerësim pozitiv në testin e hyrjes dhe të shpallet fitues për pranimin në programin e studimit. Ky test zhvillohet me shkrim në gjuhën italiane;</li> </ol> <p><b>(Ev. 40; Ev. 41; Ev. 42)</b></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Kolegji Universitar REALD, çdo vit akademik harton dhe realizon procedura specifike të bursave dhe ndihmës për shtresat në nevojë dhe për studentët ekselente në varësi të arritjeve akademike. Politikatat e bursave të studentëve hartohen dhe miratohen nga Bordi i Administrimit të KUR. Bursa të plota apo dhe gjysmë bursash mund të jepen edhe për studentë me aftësi të kufizuar, studentë nga komuniteti egjiptian apo studentë që janë fëmijë të punonjësve, që kanë rënë në krye të detyrës. <b>(Ev. 43)</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>-IAL ka hartuar Statute dhe Rregullore në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto dokumenta janë shkruar qartë politikatat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje.</i></p> <p><i>-Procedurat e pranimit realizohen mbi bazën e kriterëve specifike të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit Bachelor “Higjenist Dentar”, si edhe sipas Udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve.</i></p> <p><i>-Institucioni bashkëpunon me RASH dhe QSHA për procedurat e regjistrimit dhe të transferimit të studentëve.</i></p> <p><i>- Kuotat e pranimit bëhen publike nga IAL-të dhe i përcillen Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe Ministrisë përgjegjëse</i></p>

	<p><i>për arsimin.</i></p> <p><i>-Kolegji Universitar Reald, çdo vit akademik harton dhe realizon procedura specifike të bursave dhe ndihmës për shtresat në nevojë për studentët ekselentë në varësi të arritjeve akademike, dhe për studentët nga shtete të tjera të cilët janë të interesuar për të ndjekur studimet.</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Në rregulloren e Njesisë Bazë si dhe rregulloren e programit të studimit, studenti gjen informacion të plotë në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Në rregullore është përcaktuar shkalla e frekuentimit për programin e studimit (të detyruara 75% të aktiviteteve të zhvilluara në auditor, neni 10).</p> <p>Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se në sekretarinë mësimore të FSHM mbahet regjistri i frekuentimit të procesit mesimor nga studentët e çdo grupi mësimor, i cili plotësohet për çdo orë mësimore. Në rregullore përcaktohen gjithashtu kriteret dhe procedurat për kalimin nga njëri vit në tjetrin. Studenti lejohet të hyjë në mbrojtjen e diplomës, pasi ka fituar të gjitha kreditet e parashikuara në programin mësimor. Informacioni është i aksesueshëm edhe në faqen elektronike të IAL:</p> <p><a href="https://unireald.edu.al/studentet/kalimi-ne-vitin-pasardhes/">https://unireald.edu.al/studentet/kalimi-ne-vitin-pasardhes/</a></p> <p><b>(Ev. 4: Ev. 6)</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Në rregulloren e departamentit dhe të programit të studimit, studentët kanë informacion për kriteret e njohjes së kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesshme. Në të dy rregulloret ka nene specifike për procedurat e transferimit apo të ekuivalentimit të lëndëve si dhe për mundësitë e ndjekjes së programeve të dyta të studimeve. Studentët informohen përmes sekretarisë mësimore dhe Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të</p>






	<p>Cilësisë. Në departament ngrihet një komision ad-hoc, i cili vlerëson dhe njeh kualifikimet e mëparshme bazuar në dokumentacionin, i cili përfshin planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve. I gjithë procesi i transferimit dhe njohjes së krediteve të mëparshme, zhvillohet brënda afatve ligjore dhe ndjek hap pas hapi të gjitha procedurat e përcaktuara në ligj dhe në rregullore. (Ev. 4; Ev. 6; Ev. 58; Ev.59)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Procedurat e vlerësimit të dijeve janë të saktësuara në nenet e rregullores së programit të studimit (neni 8) dhe të detajuara në syllabuset e lëndëve. Në secilin syllabus përcaktohet skema e kontrollit të dijeve e cila ndahet në vlerësimin e vazhdueshëm (40%) dhe provimin përfundimtar (60%).</p> <p>Kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet testimeve/provimeve me shkrim/me gojë/ projekteve/ prezantimeve/ praktikave. Në programin e lëndës shprehen modalitetet e vlerësimit dhe detyrimet e studentit, të cilat i bëhen të njohura studentëve me fillimin e procesit mësimor, në ditën e parë të çdo lënde.</p> <p>Në takimin me studentët GVJ konstatoi se studentët janë të kënaqur me cilësinë e mësimdhënies dhe transparencën e vlerësimit. Ata përdorin edhe procedurat e rishikimit të vlerësimit.</p> <p><b>(Vizita në Institucion, takimi me studentët; Ev. 6; Syllabuset e lëndëve)</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në rregulloren e IAL dhe rregulloren e programit të studimit, janë përcaktuar qartë mënyra e diplomimit. Institucioni ka përgatitur dhenjë manual udhëzues për përgatitjen e temës së diplomës. Në rregullore përcaktohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Diplomimi bëhet me mbrojtjen e mikrotezës, ose me provim;</li> <li>-Miroteza nuk është kriter detyrues, ajo përcaktohet në bazë të notës mesatare;</li> <li>-Për tezën e diplomës rregullorja përcakton karakteristikat dhe strukturën e tezës së diplomës;</li> <li>-Kushtet që duhet të përmbushë studentit për marrjen e diplomës dhe procedurën e diplomimit;</li> </ul> <p>GVJ konstatoi se emërtimi i diplomës përputhet me programin e studimit dhe objektivat formuese dhe karakterizuese të tij (diploma dhe suplementi i diplomës). Departamenti përcakton listën e temave të diplomave në fillim të semestrit të parë të vitit të tretë akademik. Ky përcaktim bëhet duke u mbështetur në fushat e studimit që mbulon departamenti. Lektorët që</p>




	drejtojnë studentët në përgatitjen e mikrotezës, kanë formimin e duhur. (Ev. 4; Ev. 6; Ev. 8; Ev.20)			
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	<p>Informimi i publikut për programet e studimit realizohet përmes fletë palosjeve, posterave dhe organizimit të ditëve informuese (zakonisht në periudhën mars – maj). Informacioni përditësohet dhe në faqen ëeb të KUR. Institucioni me anë të strukturave si Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI realizon gjurmimin e studentëve dhe organizimin e ditëve informuese.</p> <p>Para fillimit të vitit akademik IAL, harton kalendarin përkatës dhe organizon takime në shkollat e mesme, me nxënësit maturantë për ti njohur ata me programet e studimit që ofron KUR. Kalendarin i përcillet për dijeni Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar. Gjithashtu personat e interesuar, marrin informacion për programet e studimit që ofron IAL, edhe nëpërmjet spoteve publicitare në media të ndryshme.</p> <p>(Ev. 92; Ev. 93)</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>-Në rregulloren e departamentit, rregulloren e programit të studimit, dhe syllabuse, studenti gjen informacion të plotë në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin, si dhe shkallën e frekuentimit të detyruar për programin e studimit.</i></p> <p><i>-Studentët kanë informacion për kriteret e njohjes së kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesshme.</i></p> <p><i>-Procedurat e vlerësimit të dijeve janë të saktësuara në nenet e rregullores së programit të studimit dhe të detajuara në syllabuset e lëndëve. Në secilin syllabus përcaktohet skema e kontrollit të dijeve, e cila ndahet në vlerësimin e vazhdueshëm dhe provimin përfundimtar.</i></p> <p><i>-Institucioni ka përgatitur dhe një manual udhëzues për përgatitjen e temës së diplomës.</i></p> <p><i>-Informimi i publikut për programet e studimit realizohet përmes fletë palosjeve, posterave dhe organizimit të ditëve informuese. Ky informacion përditësohet dhe në faqen elektronike zyrtare të KUR, si dhe në media të ndryshme.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>




<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Studentët që ndjekin programin e studimit Bachelor në “Higjenist Dentar”, informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën e programit, organizimin dhe kohëzgjatjen. Përmes kontakteve me Njësinë Bazë, Sekretarinë Mësimore si dhe përmes ëbebit ato gjejnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Informacion mbi institucionin që ofron programin e studimit;</li> <li>• Informacion për objektivat formuese të programit;</li> <li>• Strukturën dhe organizimin e programit;</li> <li>• Planin mësimor;</li> <li>• Syllabuset;</li> <li>• Rregulloren;</li> <li>• Suplementin e diplomës, etj;</li> </ul> <p>Në fillim të çdo viti akademik, bëhen takime me studentët e viteve të para, ku shpërndahehet çdo informacion në lidhje strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programeve të studimit. Programi i studimit Bachelor në “Higjenist Dentar”, zhvillohet në 3 vite akademike, 6 semestra dhe përmban 180 kredite (ECTS). Forma e studimit është me kohë të plotë.</p> <p><b>(Vizita në Institucion, takimi me studentët; Ev. 2; Ev. 4; Ev.48)</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>GVJ konstaton se dokumentacioni shpjegues për programin e studimit është i plotë dhe i organizuar në përputhje me kërkesat e ligjit të arsimit të lartë dhe akteve nënligjore në fuqi. Në këtë dokumentacion, i cili vihet në dispozicion nga çdo lektor i lëndës, në orën e parë të çdo semestri, studenti gjen informacion të detajuar për lëndët e modulet, organizimin dhe shpërndarjen e tyre në semestra, ECTS për secilën lëndë e modul, klasifikimin e lëndëve sipas tipit të veprimtarisë formuese. Në syllabuse studenti orientohet për tematikat dhe mënyrën e organizimit të orës së mësimit (leksion, seminar, praktikë). Studenti i merr të dhënat dhe nga faqja ëeb e Institucionit.</p> <p><b>(Syllabuset per tre vitet e fundit)</b></p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Në takimin me grupin e vlerësimit të brendshëm, GVJ kërkoi informacion mbi mënyrën e orientimit të studentëve mbi mundësitë e punësimit. Institucioni ka lidhje të ngushta me spitalet rajonale dhe klinika të ndryshme dentare dhe institucione të tjera shëndetësore, ku marrin informacion për vendet e lira të punës. Një rol të rëndësishëm në këtë proces luan Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI. Institucioni ka mundësuar përfshirjen e studentëve në një sërë aktivitesh informuese në lidhje me kërkesat e punëdhënësve. Pjesmarrja e studentëve në aktivitete trajnuese brenda qytetit dhe me gjerë në rajon, shton mundësitë e informimit dhe promovimit të studentëve në tregun e punës.</p> <p><b>(Vizita në institucion, Takimi me studentët dhe përfaqësues të Zyrës së karrierës dhe Alumni), (Ev. 60)</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ gjatë vlerësimit të dokumentacionit dhe takimit me studentët, evidenton që ata informohen hollësisht dhe gjëresisht për infrastrukturën dhe organizimin e programit të studimit, duke filluar nga organizimi i syllabuseve, orari i mësimit, aktivitetet jashtë kurrikulare, logjistikën, laboratorët, modalitetet e organizimit të praktikave profesionale dhe strukturat ndihmëse, në fillim të çdo viti akademik. Praktika profesionale ofrohet sipas marrëveshjeve, në spitale dhe klinika të ndryshme dentare, si dhe në laboratorët e mirëpajisur brenda institucionit. Në funksion të studentëve është dhe biblioteka dhe shërbimet e sekretarisë.</p> <p><b>(Vizita në institucion, Takimi me studentët; Ev. 9; Ev. 52; Ev. 53)</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Në RVB theksohet se KUR ka një sistem informatik të brendshëm SMI, përmes të cilit mundësohet informimi i studentit për programin e studimit. Studenti disponon një kod personal përmes të cilit mund të aksesojë të dhënat e tij në çdo moment, si dhe detaje për programin e studimit, detajeve individuale për notat etj. Informacioni i detajuar dhe i rifreskuar ndodhet gjithashtu edhe në faqen elektronike të Institucionit: <a href="http://ëëë.unireaild.edu.al">ëëë.unireaild.edu.al</a> <b>(Ev. 14)</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>-Studentët që ndjekin programin e studimit Bachelor në "Higjenist dentar", informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën e programit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij.</i></p> <p><i>- Dokumentacioni shpjegues për programin e studimit është i plotë dhe i organizuar në përputhje me kërkesat e ligjit të arsimit të lartë dhe akteve nën ligjore në fuqi.</i></p> <p><i>- Gjatë vlerësimit të dokumentacionit dhe takimit me studentët</i></p>




	<i>evidentojmë që ata informohen hollësisht dhe gjërësisht për infrastrukturën dhe organizimin e programit të studimit, duke filluar nga organizimi i syllabuseve, orari i mësimi, aktivitetet jashtë kurrikulare, logjistikën, laboratorët, modalitetet e organizimit të praktikave profesionale dhe strukturat ndihmëse.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>		<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi V.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	<p>Në sekretarinë mësimore të FSHM janë të depozituara dokumentacionet e plota për numrin e studentëve për programin e studimit. Sekretaria ka:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Regjistrin themeltar të studentëve;</li> <li>• Regjistrin e lëshimit të diplomave;</li> <li>• Regjistrin me të dhënat akademike (regjistri i notave);</li> </ul> <p>Në takim me sekretarinë mësimore u informuam se regjistrat në formë të shkruar depozitohen me kohë të pacaktuar dhe arkivohen në arkivën e shtetit. Gjithashtu Institucioni përpunon të dhëna në lidhje me cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve dhe disponon të dhëna në lidhje me punësimin pas diplomimit.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Higjenist dentar”, ende nuk ka studentë të diplomuar, pasi diplomimet e para do të bëhen në vitin në vijim, dhe për këtë arsye nuk kanë të dhëna lidhur me numrin e studentëve të diplomuar.</p> <p><b>(Vizita në institucion, Takimi me sekretarinë mësimore; Ev. 81; Ev. 82)</b></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimet në institucion, GVJ konstaton se institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, largimin apo tërheqjen e studentëve nga programi i studimit. Në sekretari depozitohen dosjet e studentëve të plotësuar sipas kuadrit ligjor në fuqi, listat e frekuentuesve si dhe një</p>




<p>programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>numër dokumentacionesh për procedurat e transferimit dhe të çregjistrimit. Këto të dhëna ruhen edhe në sistemin SMI dhe menaxhohen nga sekretaria mësimore dhe zyra e statistikave.</p> <p>Nga vizita në sekretarinë mësimore rezultoi se numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi për tre vite akademike është si më poshtë vijon:</p> <p>Viti akademik 2020-2021 38 studentë;</p> <p>Viti akademik 2021-2022 11 studentë;</p> <p>Viti akademik 2022-2023 7 studentë;</p> <p><b>(Vizita në institucion, Takimi me sekretarinë mësimore; Ev. 81)</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Për menaxhimin e të dhënave statistikore të studentëve, GVJ në takimin me punonjësit e sekretarisë mësimore inspektoi hapësirat e punës dhe arkivimit të dokumentacionit dhe u njoh me një numër dokumentesh si dosja e studentit, dosja e personelit, regjistrat.</p> <p>Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes një sistemi të brendshëm të infomacionit nga dy struktura përkatëse: Drejtoria e Standardeve dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si dhe nga Sekretaria mësimore. Ato janë të disponueshme si në sekretarinë mesimore në formë shkresore, ashtu edhe në formë elektronike në sistemin SMI. Këto të dhëna janë të verifikueshme nga personat e autorizuar, duke respektuar kuadrin ligjor për mbrojtjen e autorizuar të të dhënave, informacioni personal i studentëve ruhet në mënyrë konfidenciale dhe shpërndahe vetëm për palët e autorizuara në plotësim të kriterëve që përcaktohen në ligjin "Për mbrojtjen e të dhënave personale" si dhe në përputhje me ligjet dhe aktet nën ligjore për Arsimin e Lartë si dhe në bazë të Rregulloreve të funksionimit të KUR.</p> <p><b>(Vizita në institucion, Takimi me sekretarinë mësimore; Ev. 9; Ev. 16; Ev. 98)</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit</p>	<p>KUR ka përpiluar mekanizma ku ndërmjet dhe drejtorive përkatëse, të cilat lidhen me organizimin e punës, kryhen kontrole periodike (auditim të brendshëm) pranë sekretarive mësimore dhe departamenteve ku bëhet vlerësimi i dokumentimit dhe menaxhimit të informacionit dhe dokumentacionit të ruajtur dhe sistemuar. <u>GVJ nuk gjeti raporte auditimi.</u></p>



dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	<b>(Vizita në institucion; Ev. 16)</b>			
<b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	<p>Raportet analitike përpilohen në formën e analizës vjetore të njësisë bazë dhe asaj kryesore (evidencat e analizave gjenden në dokumentacion). Në këto raporte ka të dhëna kryesisht për kalueshmërinë, frekuentimin dhe diplomimin. Të dhënat e punësimit merren nga Urdhërat profesional, të çdo profesioni.</p> <p>Gjatë takimeve u deklarua që kërkesa të shtuara për punësim ka edhe jashtë Shqipërisë. Zyra e Këshillimi të Karrierës dhe Alumni realizon skedimin e informacionit për punësimin.</p> <p><b>(Ev. 82; Ev. 110)</b></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>-Në sekretarinë mësimore të FSHM, janë të depozituara dokumentacionet e plota për numrin e studentëve për programin e studimit. GVJ konstaton se institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, largimin apo tërheqjen e studentëve nga programi i studimit.</i></p> <p><i>-Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes një sistemi të brendshëm të infomacionit.</i></p> <p><i>-IAL përpilon raporte në formën e analizës vjetore të cilët përfshijnë të dhëna kryesisht për kalueshmërinë, frekuentimin dhe ecurinë e procesit mësimor. Të dhëna për diplomimin nuk ka, pasi programi i studimit ende nuk ka studentë të diplomuar.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre	Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin e KUR dhe Rregulloret e institucionit, garantohet e drejta e studentëve ose përfaqësuesve të tyre për pjesëmarrje në organet vendim

<p>në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>marrëse dhe këshilluese të KUR.</p> <p>Në RVB theksohet se studentët janë të përfaqësuar në Senatin e KUR me një senator i cili zgjidhet nga vetë studentët. Studentët janë pjesëmarrës në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Këshillat studentore,</li> <li>• Njësinë e sigurimit të brendëshëm të cilësisë;</li> <li>• Senatin Akademik;</li> <li>• Grupin e vetëvlerësimit për akreditimin institucional,</li> </ul> <p>Studentët kanë qenë pjesëmarrës dhe në hartimin e RVB.</p> <p><b>(Ev.2; Ev. 4; Ev. 37)</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në vendimmarrje dhe vlerësim të procesit akademik realizohet përmes përfaqësuesve të tyre në organet e zgjedhura, por dhe përmes tërheqjes dhe vlerësimit të opinionit të tyre në raport me mësimdhënien, praktikën profesionale, përfshirjen në projekte e grupe studimore. Në takimin me studentët, GVJ konstaton se studentët plotësojnë pyetësorë në mënyrë periodike, përfshihen në punë studimore dhe aktivitete promovionale e trajnuese të organizuara nga FSHM. Studentët shprehen të kënaqur për përfshirjen e tyre dhe angazhimin për mbarëvajtjen dhe përmirësimin e procesit akademik.</p> <p><b>(Takimi me studentët; Ev. 35; Ev. 37)</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit është ndërtuar mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi duke respektuar të gjitha kriteret për ngarkesën në auditor dhe jashtë tij si dhe për shpërndarjen e ngarkesës në orë teorike dhe praktike. Në takimin me studentët ata vlerësuan pozitivisht cilësinë e mësimdhënies. Studentët gjykojnë se praktikat në laboratorët simulatorë dhe praktikat profesionale në klinika, i përgatisin mjaft mirë për tregun e punës. Raportin teori-praktikë e vlerësojnë shumë të mirë. Për tërheqjen e mendimit të studentëve në funksion të përmirësimit të programeve të studimit, institucioni përdor një seri mekanizmash. Këshilli studentor, është organizmi ku studentët diskutojnë dhe problematikat e trajtuara i adresojnë në forumet drejtuese të FSHM për zgjidhje. Koordinator i programit është në kontakt të përhershëm me studentët dhe shërben si urë komunikimi midis tyre dhe stafit të departamentit, për të adresuar problemet që dalin në kohë reale. Pyetësorët e plotësuar nga studentët janë një tjetër mekanizëm për tërheqjen e mendimit</p>




	<p>të tyre. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies kryhet për të gjithë pedagogët me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme. Rezultatet e vlerësimit bëhen transparente dhe i vihen në dispozicion individualisht, të gjithë anëtarëve të stafit akademik të vlerësuar, përgjegjësve të departamentit, si dhe dekanit.</p> <p><b>(Vizita në institucion, Takimi me studentët dhe koordinatorin e programit të studimit)</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit përcaktohet qartë procedura e vlerësimit dhe e ankesës së studentit për rezultatin e provimit. Në takim me GVJ, studentët shprehen të kënaqur me mënyrën e organizimit të provimeve dhe me mundësitë që ata kanë për ankimim rezultati dhe rishikim të tezës së provimit. Në bazë të rregullores, departamenti pas procesit të ankimit, ngre një komision rivlerësimi të ndryshëm nga komisioni i parë, i cili bën rishqyrtim dhe rivlerësim të provimit. Procedura u shpjegua si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Studenti bën kërkesë për rivlerësimin e tezës së provimit, të cilën e dorëzon në sekretarinë mësimore brenda 48 orëve nga marrja e rezultatit të provimit;</li> <li>• Ankesa me shkrim i paraqitet Drejtuesit të Njësisë Bazë, i cili vë në djeni Dekanin;</li> <li>• Dekani brenda 48 orësh nga marrja e ankesës, ngre një komision ad-hoc prej 3 anëtarësh, për të rivlerësuar tezën e provimit;</li> </ul> <p>Nga takimi me stafin akademik dhe studentët u vërejt se fryma në institucion është tepër pozitive. Është në filozofinë e institucionit që studentët të vlerësohen drejt dhe të përvetësojnë sa më shumë dije.</p> <p><b>(Ev. 4; Ev. 5; Vizita në institucion, Takimi me studentët)</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>- Studentët janë të përfaqësuar në Senatin e KUR me një senator i cili zgjidhet nga vetë ata. Studentët janë pjesëmarrës në Këshillet studentorë, në Komisionin e përhershëm për standartet e cilësisë, etj. Studentët kanë qenë pjesëmarrës dhe në hartimin e RVB.</p> <p>-Përfshirja e studentëve në vendimmarrje dhe vlerësim të procesit akademik realizohet edhe përmes tërheqjes dhe vlerësimit të opinionit të tyre në raport me mësimdhënien, praktikën profesionale, përfshirjen në projekte e grupe</p>

	<p><i>studimore.</i></p> <p><i>-Në takimin me studentët ata vlerësuan pozitivisht cilësinë e mësimdhënies. Në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit përcaktohet qartë procedura e vlerësimit të ankesës së studentit për rezultatin e provimit.</i></p> <p><i>-Kordinatori i programit është në kontakt të përhershëm me studentët dhe shërben si urë komunikimi midis tyre dhe stafit të departamentit për të adresuar problemet që dalin në kohë reale.</i></p> <p><i>-Kordinatori kujdeset për përfshirjen e studentëve në procesin e rishikimit të kurrikulës.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

#### Standardi V.6

**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>KUR ka procedura dhe njësi të posaçme në shërbim të informimit të studentëve në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve, programin e studimit dhe aktivitete të lidhura me procesin mësimor. Në funksion të informimit të studentëve janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zyra e Karrierës dhe ALUMNI;</li> <li>- Sekretaria mësimore; e hapur cdo ditë për studentët dhe ofron shërbim akademik nga regjistrimi në diplomim;</li> <li>- Drejtoria e Standarteve dhe e Sigurimit të Cilësisë;</li> <li>- Zyra e IT;</li> </ul> <p>Zyra e Karrierës realizon informimin e studentëve dhe të gjitha shërbimet që nga momenti i regjistrimit deri në diplomim, nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë, shpalljen e njoftimeve në ambientet e Universitetit, në ëbsite ose rrjete sociale. Njëkohësisht Zyra e Karrierës ka si funksion parësor të saj ofrimin e mundësive për vende pune, trajnime dhe internship-e për studentët aktualë dhe ata që janë diplomuar</p>




	<p>pranë KUR.</p> <p><b>(Ev. 12)</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Sistemi për informimin, këshillimin, ndjekjen dhe përparimin e studentëve i përshkruar në Kriterin 1, është funksional dhe i përshtatshëm. Gjatë vizitës në institucion, studentët u shprehën të kënaqur për aksesin në informacion, për disponibilitetin e sekretarisë për asistimin në aspekte të procesit mësimor, për pjesmarrjen në aktivitete shkencore, promovuese dhe trajnuese bashkë me pedagogët. Të gjithë informacionet e nevojshme në lidhje me procesin mësimor ishin lehtësisht të aksesueshme nga ata, si dhe u shprehën se kishin mbështetjen e nevojshme nga Zyra e Karrierës për çdo çështje, që lidhej me përparimin e mëtejshëm të tyre.</p> <p><b>(Vizita në institucion, takimi me studentët)</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Në institucion funksionon Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës. Studentët gjejnë mbështetje dhe informacione të vlefshme pranë kësaj zyre. Zyra e këshillimit të karrierës i ndihmon studentët për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikimin i lidhjeve midis diplomës që do të marrin dhe mundësive për karrierë;</li> <li>• Identifikimin e burimeve për pozicione të veçanta pune;</li> <li>• Zhvillimin e strategjive për mënyrën e të kërkuarit të punës;</li> <li>• Identifikimin e aftësive dhe shprehive;</li> </ul> <p>Në këtë zyrë studentët gjejnë mbështetje për përgatitje për intervista pune, shkrimin e CV dhe letrave të motivimit etj.</p> <p><b>(Ev. 12; Vizita në institucion, takimi me studentët dhe me përfaqësues të zyrës së Këshillimit dhe Karrierës)</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Në takimin e GVJ me Zyrën e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës u informuam se kjo zyrë asiston në gjurmimin e studentëve edhe pas diplomimit. Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës mban lidhje me studentët e diplomuar nëpërmjet adresave të tyre personale të emailit dhe ka krijuar një data - bazë të të dhënave, të cilat përditësohen çdo vit. Këto të dhëna gjurmimi të studentëve pas përfundimit të studimeve u vihen në dispozicion edhe departamenteve, duke i ndihmuar ata të kenë kontakte të vazhdueshme midis studentëve të diplomuar dhe FSHM dhe Departamentit të Stomatologjisë. Përsa i përket programit të studimit Bachelor</p>




	<p>“Higjenist Dentar”, ende nuk ka një brez i studentësh të diplomuar. Megjithatë të dhënat dhe statistikat në lidhje me punësimin e studentëve të programeve të tjera të studimit, ndihmojnë studentët për zhvillimin e mëtejshëm profesional dhe ngritjen e një karriere të sukseshme.</p> <p><b>(Ev. 81; Vizita në institucion, takimi me studentët dhe me përfaqësues të zyrës së Këshillimit dhe Karrierës)</b></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p>-FSHM ka procedura dhe njësi të posaçme në shërbim të informimit të studentëve në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p> <p>-Në institucion funksionon Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, pranë së cilës studentët gjejnë mbështetje dhe informacione të vlefshme.</p> <p>-Kjo zyrë mban lidhje me studentët e diplomuar nëpërmjet adresave të tyre personale të emailit, si dhe ka krijuar një data - bazë të të dhënave, të cilat përditësohen çdo vit.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>



<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Implementimi dhe përdorimi i metodave inovative të mësimdhënies më qëllim rritjen e cilësisë akademike është një proces i rëndësishëm në përmirësimin e performancës së institucioneve të arsimit të lartë. KUR në strategjinë e zhvillimit institucional, një vënd të rëndësishëm i kushton zhvillimit të metodave inovative të mësimdhënies me qëndër studentin duke promovuar mendimin kritik, dialogun student/pedagog dhe përgatitjen e studentëve të aftë, për tu përshtatur kërkesave të tregut të punës.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se KUR, ka hartuar disa udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies. Përmëndim këtu manualet e përdorimit të teknologjisë në distancë, apo udhëzuesin për punimin e diplomës. Personeli akademik trajnohet vazhdimisht përmes pjesëmarrjes në projekte të ndryshme, zhvillimit të leksioneve të hapura nga lektorë të ftuar jashtë universitetit, vizitat studimore etj.</p> <p><b>(Ev. 17; Ev. 19; Ev. 20).</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Institucioni ka ngritur dhe ka funksional sistemin e sigurimit të cilësisë në nivel Institucional, i cili monitoron dhe vlerëson periodikisht cilësinë e programit të studimit. Kështu pranë KUR - është ngritur dhe funksionon NJSBC, në bazë të Rregullores së NJSBC, ku përshkruhet si funksionojnë dhe bashkërendojnë punën njësisia qendrore me njësitë në çdo fakultet. Njësia ka në përbërjen e saj staf akademik staf administrativ, dhe studentë.</p> <p>Sektori i Kurikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore monitoron në mënyrë periodike cilësinë e programeve të studimit, aplikimin e metodave të reja të mësimdhënies, rekrutimin e stafit me gradat dhe titujt e duhura, anketimet dhe kontrollet e vazhdueshme të procesit mësimor, si dhe çdo aktivitet që shërben në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe jetës studentore. Vlerësimi dhe monitorimi i cilësisë së programit realizohet nëpërmjet pyetësorëve, të cilët përgatiten nga NJSBC dhe miratohen nga senati. Çdo vit realizohen pyetësorë për matjen performancës dhe cilësinë e mësimdhënies si: pyetësorë për vlerësimin e lëndës, për vlerësimin e lektorit dhe Infrastrukturën. Gjithashtu analizohet kalendari i realizimit të aktiviteteve të aprovuar në fillim të çdo viti akademik, pyetësorët e vetvlerësimit të stafit akademik. Këto u theksuan dhe gjatë takimit me stafin akademik dhe studentët. Në fund të çdo viti akademik NJSBC</p>




	<p>të cilësisë në nivel institucional, i cili monitoron e vlerëson periodikisht cilësinë e programit të studimit.</p> <p>-Studentëve u garantohet e drejta për të qënë pjesë aktive e Komisionit të Përhershëm për Standardet e Cilësisë, si edhe e komisioneve të tjerë në nivel institucional, fakulteti dhe departamenti.</p> <p>- NJSBC në fund të çdo viti harton një raport në nivel institucional.</p> <p>-Të dhënat e raportit të NJSBC i shërbejnë promovimit të praktikave të mira dhe nxitjes së stafit akademik për përmirësim të mësimdhënies si dhe përcaktimin e kriterëve dhe afateve për rishikim të kurikulave, hartimin e procedurave për përzgjedhjen e tekseve mësimore dhe aplikimin e teknologjisë mësimore, përmirësime të infrastrukturës mësimore etj.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi VI.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë, institucioni ka hartuar politika dhe procedura, si dhe ka ngritur struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë në rang Kolegji. Politikat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë janë sanksionuar në statutin e KUR, në rregullorene institucionit si dhe në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2021-2026. Objektivat e sigurimit të cilësisë evoluojnë në përputhje me analizën e situatës dhe me qëllimet e objektivat e zhvillimit të institucionit. Senati akademik është aktiv në mbështetje të implementimit të politikave të sigurimit të cilësisë. (Ev. 3; Ev. 11; Ev. 37)
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për	KUR ka ngritur Sistemin e brëndëshëm të Sigurimit të Cilësisë, ku përfshihen edhe studentë dhe bashkëpunëtorë të jashtëm. Ky sektor mbulon të gjithë problematikat nga licensimi në akreditim. NJSBC e bazon aktivitetin e saj në:

	<p>harton raportin vjetor që e prezanton tek rektori së bashku me konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse.</p> <p><b>(Ev. 11; Ev. 111)</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Bazuar në statutin e institucionit, studentëve u garantohet e drejta për të qënë pjesë aktive e Komisionit të Përhershëm për Standardet e Cilësisë, si edhe të komisioneve të tjerë në nivel institucional, fakulteti dhe departamenti. Studentët janë pjesë aktive e vlerësimeve periodike të procesit të mësimdhënies. Bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë, studentët plotësojnë pyetësorët për vlerësimin e metodave të mësimdhënies. Në fund të çdo viti akademik, Institucioni përpilon raportin bazuar në të dhënat e tërhequra nga këta pyetësorë. Studentët janë në fokusin kryesor të Strategjisë së zhvillimit institucional dhe kontribuojnë në mënyrë direkte në vlerësimin e Institucionit në përgjithësi ashtu dhe të programeve apo lëndëve specifike. <b>(Ev. 91)</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Pranë KUR funksionon Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë, i cili në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon pyetësorin e studenteve për matjen e performancës. Në fund të çdo semestri kjo strukturë organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi. Të dhënat publikohen periodikisht me qëllim rritjen e transparencës ndaj të gjithë aktorëve të përfshirë. Me tej strukturat përgjegjëse hartojnë një raport në përmblyllje të çdo viti akademik, i cili publikohet në faqen zyrtare të KUR. Ky raport realizohet në zbatim të politikave për sigurimin e brendëshëm të cilësisë, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve të cilësisë duke u bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, Neni 103: "Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë". Ky raport është i aksesueshëm nga studentët dhe publiku në faqen web: <a href="http://eëë.unireald.edu.al">eëë.unireald.edu.al</a> <b>(Ev. 111)</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ vlerëson së të dhënat në raportin përfundimtar janë përshkruese në terma sasore dhe analitike si dhe me adresim të problematikave të hasura. Këto të dhëna shërbejnë promovimit të praktikave të mira dhe nxitjes së stafit akademik për përmirësim të mësimdhënies, si përcaktimin e kriterëve dhe afateve për rishikim të kurikulave, hartimin e procedurave për përzgjedhjen e tekseve mësimore dhe aplikimin e teknologjisë mësimore, përmirësimet të infrastrukturës mësimore etj. <b>(Ev. 104; Ev. 105; Ev. 106)</b></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>-Institucioni ka ngritur dhe ka funksional sistemin e sigurimit</i></p>




<p>përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>-Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015</p> <p>-Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (VKM 531/11.09.2018);</p> <p>-Statutin e institucionit;</p> <p>- Vendimet e senatit;</p> <p>-Urdhërat e brendshëm ;</p> <p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, funksionon si një strukturë autonome dhe e përhershme pranë institucionit. NJSBC ka detyrim institucional hartimin e raporteve. NJSBC funksionon me plan pune vjetor dhe ushtron një seri aktiviteteve si: Përcakton pyetësorët në nivel institucional për matjen e cilësisë në disa nivele, bashkërendon procesin ndërmjet njësive në nivel institucional, monitoron procesin, mbledh informacione, evidenton problematikat, ofron udhëzime dhe rekomandime në njësitë bazë, administron dokumentacione, organizon dhe përgatit vizita të vlerësimit të jashtëm. NJSBC mbështet dhe ofron ekspertizë në zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë si dhe interpreton detyrimet kombëtare dhe europiane të sigurimit të cilësisë. (Ev. 3; Ev. 115)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>KUR i është nënshtruar procesit të akreditimit institucional, dhe ka marrë masat përkatëse për të përmbushur rekomandimet e ekspertëve të jashtëm (Ev. 39).</p> <p>GVJ në bazë të dokumentacionit dhe takimit me përfaqësuesit e NJSBC, evidenton që institucioni përdor mekanizma të tillë si pyetësorët e vlerësimit të studentëve, vlerësimit të anëtarëve të stafit akademik, vetëvlerësimit të pedagogëve, vlerësimin e infrastrukturës. Njësia e sigurimit të brendshëm, deklaron se bën vlerësim periodik të veprimtarive mësimore dhe kërkimore – shkencore të KUR, si dhe harton raportet përkatëse të vlerësimit të brendshëm. Metodatat të cilat aplikohen janë: pyetësorët për studentët, inspektime gjatë zhvillimit të mësimin, leksione të hapura, intervista, vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës etj. Programi i studimit që është objekt vlerësimi po kalon për herë të parë procesin e akreditimit. (Ev. 91)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet</p>	<p>Për të analizuar arritjet në nivel institucional si dhe kontributin e tyre për arritjet e objektivave strategjike, KUR ka përcaktuar dhe treguesit e performancës. Lista e treguesve të performancës realizohet dhe rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme nga NjBSC-ja. Treguesit e performancës</p>

<p>rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira ne programin e studimit.</p>	<p>përfshijnë tregues të tillë si: niveli i regjistrimeve, niveli kalueshmërisë, niveli i diplomimit, diversiteti i profileve studentore, ndërkombëtarizimi etj. NJSBC përpiqet për monitorimin e proçeseve të brendshme të sigurimit të cilësisë, të cilat janë standartizuar si proçese që kryhen si në nivel institucional, ashtu edhe në nivel programi studimi, duke realizuar vlerësime analitike e krahasuese, si dhe proçese të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. (Ev. 91; Ev. 111)</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>-Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë, institucioni ka ndërtuar politika dhe proçedura, si dhe ka ngritur struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel institucional.</i></p> <p><i>-NJSBC kryhen monitorimin e proçeseve të brëndëshme të sigurimit të cilësisë, të cilat janë të standartizuara si proçese që kryhen në mënyrë periodike, si në nivel institucional dhe në nivel programi studimi, duke realizuar vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proçese të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</i></p> <p><i>- Për të analizuar arritjet në nivel institucional si dhe kontributin e tyre për arritjet e objektivave strategjike, KUR ka përcaktuar dhe treguesit e performancës. Lista e treguesve të performancës realizohet dhe rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme nga NjBSC-ja dhe i propozohet për miratim Senatit Akademik.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p><b>Standardi VI.3</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e proçese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë</p>	<p>FSHM përdor mekanizma e proçese formale të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herë pas herë të programit të studimit. Disa nga instrumentat e përdorur janë pyetorët e studentëve për proçesin e mësimdhënies, si dhe analizat periodike të punës në nivel departamenti. Vetëvlerësimi është një proçes sistematik i mbledhjes, rishikimit dhe përdorimit të të dhënave sasiore dhe</p>




<p>akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>cilësore nga burime të ndryshme, me qëllim përmirësimin e mësimnxënjes së studentëve dhe vlerësimin e përmbushjes së standarteve akademike. Miratimi i programit të studimit kalon nëpërmjet një procedure formale, e cila nis me propozimin e Njësisë bazë, miratimin në Dekanat dhe miratimin në Senatit Akademik. Ky i fundit ja kalon për miratim Bordit të Administrimit.</p> <p>Institucioni ka ngritur dhe ka funksionale një njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikqyrjen dhe rishikimin e programeve të ciklit të parë të studimeve, që të vlerësojë në mënyrë periodike rezultatet e veprimtarive kërkimore-shkencore në njësisë kryesore të FSHM në përputhje me standardet si dhe të monitorojë punësimin e studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga IAL. Në përmbushjen e këtyre qëllimeve gjatë diskutimeve me drejtuesit u theksua se një rol të rëndësishëm kanë departamentet e FSHM, ku koordinatori i programeve realizon funksione specifike në lidhje me rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit duke u bazuar gjithmonë në parashikimet ligjore dhe në strategjinë e sigurimit të cilësisë së IAL.</p> <p>Proçesi i monitorimit dhe shqyrtimit të programit të studimit kryhet kryesisht mbi bazën e veprimtarive të përgjithshme dhe në funksion të cilësisë. Në procedurat e realizuara në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, GVJ identifikoi rezultate të proçeseve të anketimit të studentëve. Njësia luan rol kryesor jo vetëm në hartimin e planit të punës apo zhvillimin e pyetësorëve standart, por dhe në përfshirjen e metodave të tërthorta të vlerësimit dhe verifikimit, të cilat sigurojnë që rezultatet e sondazheve të përafrohen realitetit në të cilin ndodhet institucioni. NJSBC është duke plotësuar dhe konsoliduar veprimtarinë e saj, duke u bazuar në rekomandime dhe plane pune që adresojnë përmirësimin e problematikave të evidentuara.</p> <p><b>(Ev. 11; Ev. 78; Ev. 111; Vizita në Institucion)</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e</p>	<p>Njësia kryesore, në fund të çdo viti akademik përgatit analizën vjetore e cila i përcillet departamenteve për konsultim dhe reflektim, në funksion të përmirësimit të programit të studimit. Të dhënat e vlerësimit përfshihen në raportet vjetore të departamentit dhe FSHM. Në mbledhjet e departamentit ku analizohen të dhënat e vlerësimit hartohet dhe plani i masave për adresimin e mangësive dhe përmirësimin e cilësisë. Të dhënat i dërgohen Senatit të KUR, duke krijuar mundësi më të shpejtë adresimi dhe zgjidhje të problematikave. KUR duke</p>






<p>arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>vlerësuar situatën e krijuar harton planin e masave konkrete në përmirësim të cilësisë së procesit mësimor. Kjo ka ndodhur në paktën dy raste:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Plan i masave për minimizimin e rreziqeve për shkak të gjëndjes së fatkeqsisë natyrore të shkaktuar nga Pandemia Covid-19;</li> <li>- Plan i masave që lidhet me realizimin e detyrave të palnifikuara; (Ev. 103; Ev. 104)</li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Departamentet e FSHM në KUR, analizojnë mbarëvajtjen dhe cilësinë e programeve të studimit dhe reflektojnë vlerësimin e tyre në dokumentin e analizës vjetore. Elementët e analizës janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Numri i studentëve frekuentues;</li> <li>- Funksionimi i këshillimit akademik dhe koordinimit të praktikave;</li> <li>- Plotësimi i standarteve të grupeve mësimore;</li> <li>- Plotësimi i standarteve të stafit akademik;</li> <li>- Plotësimi i standarteve të didaktikës dhe laboratorëve;</li> <li>- Kalueshmëria dhe cilësia semestrale ;</li> <li>- Kalueshmëria dhe cilësia në provimin e praktikës profesionale;</li> <li>- Numri i të diplomuarve;</li> <li>- Konkluzionet e pyetorit të studentëve;</li> </ul> <p><b>(Takimi me stafin drejtues të FSP, NJSBC; Ev.110)</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademi e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen</p>	<p>Për vlerësimin e realizimit dhe mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit institucioni nëpërmjet Drejtorisë së Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë përdor një numër instrumentash të tërthorta vlerësimi. Një vend të rëndësishëm në këtë vlerësim zë informacioni i përpunuar nga Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni për punësimin e studentëve. Përmes kësaj zyre mbahen kontakte me studentë që kanë përfunduar më parë programin e studimit (kjo për programet e tjera, pasi ky program ende nuk ka studentë të diplomuar), meret informacion për punësimin e tyre apo kualifikimet e mëtejshme pas përfundimit të programit të studimit. Metoda të tjera janë sondazhe me studentët aktual që ndjekin programin e studimit. Këto sondazhe shërbejnë për të vlerësuar si mirëpritën studentët në tregun e punës dhe si vlerësohet aftësia që ata kanë fituar nga programi i studimit</p>




<p>në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>dhe integrimi i tyre në tregun aktual. Institucioni informohet në mënyrë periodike për rezultatet e studentëve në provimin e licencës. Pasi përpunohen të dhënat, rezultatet bëhen publike nëpërmjet një raporti të shkruar apo dhe takimeve të hapura me stafin akademik të njësisë kryesore, me qëllim evidentimin e problematikave të hasura dhe mundësitë për ndryshime në programin e studimit, në mënyrë që të rritet cilësia e mësimdhënies.</p> <p><b>(Vizita në institucion, Takimet me përfaqësues të zyrës së Karrierës dhe Alumnit; Ev. 11; Ev. 36)</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>-KUR përdor mekanizma e proçese formale të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herë pas hershme të programit të studimit.</i></p> <p><i>-Njësia kryesore, në fund të çdo viti akademik përgatit analizën vjetore e cila i përcillet departamenteve për konsultim dhe reflektim në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</i></p> <p><i>-Të dhënat e vlerësimit të programeve të studimit përfshihen në raportet vjetore të KUR. Në mbledhjet e departamentit ku analizohen të dhënat e vlerësimit, hartohet dhe plani i masave për adresimin e mangësive dhe përmirësimin e cilësisë.</i></p> <p><i>-Për vlerësimin e realizimit dhe mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit institucioni nëpërmjet Drejtorisë së Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë, përdor një numër instrumentash të tërthorta vlerësimi si nr. e studentëve të licensuar, të punësuar etj.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi VI.4</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e</p>	<p>Në statutin, rregulloren dhe planin strategjik 2021-2026 të KUR, përfshihen politikat që do të ndërmerren për të përmirësuar programin e studimit në përputhje me konventën europiane, planin e ndërkombëtarizimit të KUR, nëpërmjet bashkëpunimit me institucione ndërkombëtare në mënyrë që</p>




<p>aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>programi i studimit të njihet sa më lehtë në vëndet e huaja dhe/ose realizimin e diplomave të dyfishta. Në funksion të këtij qëllimi, prioritare mbetet zhvillimi i programeve mësimore në gjuhën Angleze dhe Italiane, rritja e numrit të profesorëve dhe studiuesve të huaj nga universitetet prestigjioze ndërkombëtare, por edhe rekrutimi i studentëve të huaj. Nxitja dhe mbështetja e kërkimit shkencor, do realizohen nëpërmjet zhvillimit të projekteve kërkimore të stafit akademik dhe përfshirjen e studentëve. Për përmirësimin e vazhdueshëm i cilësisë së programeve të studimit, institucioni ka përfshirë aktorët e brendshëm dhe të jashtëm në hartimin e politikave të zhvillimit strategjik dhe në politikat e ndërmarra për ndërkombëtarizimin e programit të studimit. (Ev. 3; Ev. 2)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ u takua me aktorë të rëndësishëm të jetës akademike, Dekanin e FSHM, Përgjegjësin e Departamentit të Stomatologjisë, Përfaqësues të Stafit Akademik, Grupin e Vetëvlerësimit, përfaqësues të NJSBC dhe Zyrës së Karrierës. Në këto takime doli në pah organizimi i mirë i punës së përditshme, koordinimi dhe angazhimi optimal në procesin e akreditimit, motivimi, përgjegjësia dhe entuziazmi për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Në rregulloret e institucionit dhe në rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar qartë detyrat konkrete për pozicionet individuale dhe njësitë në raport me sigurimin e cilësisë. Sigurimi i brendshëm i cilësisë së programit të studimit, është konceptuar si Përgjegjësi dhe angazhim lidhur me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Harmonizimin e veprimtarisë të të gjithë strukturave drejtuese për të garantuar cilësinë e programit të studimit bachelor “Higjenist Dentar”;</li> <li>-Sigurimin e burimeve njerëzore dhe infrastrukturës për të garantuar dhe përmirësuar cilësinë e programit të studimit;</li> <li>-Hartimin e një programi cilësor që plotëson nevojat e shoqërisë;</li> <li>-Përcaktimin e parimeve, standardeve dhe procedurave të përshtatshme për monitorimin, vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë,</li> </ul> <p>GVJ konstatoi se të gjithë aktorët e përfshirë në proces ishin të koordinuar, për të realizuar një proces sa më korrekt me vetëbesim për punën dhe kapacitetet e tyre. Institucioni tregoi aftësi menaxhuese dhe drejtuese largpamëse dhe përforcoi ndjesinë pozitive se stafi jep më të mirën duke</p>




	<p>punuar e bashkëvepruar konform rregullave, në harmoni të plotë. Studentët u shprehën entuziastë për programin e studimit. Ata referuan se janë të përfshirë në vetëvlerësim përmes pyetsorëve, propozimeve të këshillit studentor si dhe përmes përfaqësuesve të tyre në GVB.</p> <p><b>(Vizita në institucion; Ev. 5; Ev. 6; Ev 11).</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>NJSBC funksionon në nivel institucioni KUR, dhe koordinon sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në të gjitha njësitë kryesore dhe me tej në njësitë bazë. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit Bachelor në “Higjenist Dentar” njësia bazë garanton përfshirjen e të gjithë strukturave, të cilat janë përgjegjëse për programin e studimit, siç është personeli akademik, ndihmës akademik e administrativ, dhe sigurisht të studentëve. Njësia e Sigurimit të brendshëm të Cilësisë, është organ kolegjal dhe miratohet me vendim të Senatit Akademik. Ajo përbëhet nga 5 anëtarë (personel akademik, ekspert i jashtëm, përfaqësues nga studentët). (Ev. 11; Ev. 37).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në përfshirjen dhe aktivizimin e aktorëve të brendshëm në proceset e vlerësimit, është respektuar liria dhe etika akademike si dhe kuadri ligjor, për mbrojtjen e të dhënave personale. Instrumenti kryesor i vlerësimit të programit të studimit, pyetësori, është realizuar në kushte të plota anonimiteti. Nuk janë referuar ankesa nga personeli apo studentët për diskriminim apo pabarazi. Procedura e vlerësimit të brendshëm i nënshtrohet Kodit të Etikës të Miratuar në KUR. Në procesin e vlerësimit respektohet integriteti akademik dhe shmanget çdo lloj forme diskriminimi apo pabarazie kundrejt stafit akademik apo studentëve. (Ev. 13; Ev. 16)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Në procesin e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit është përfshirë dhe një ekspert i jashtëm nga institucionet bashkëpunuese, proces të cilin GVJ e inkurajon. Në procesin e vlerësimit institucioni realizon takime me ish studentë të diplomuar, mjekë specialistë, ekspertë të fushës, të cilët japin mendime të vlefshme në lidhje me përmirësimin e programit të studimit dhe lidhjen më efektive me kërkesat e tregut të punës. (Ev. 2; Ev. 37).</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>-NJSBC funksionon në nivel institucioni, e cila koordinon</i></p>

	<p>sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në të gjitha njësitë kryesore dhe me tej në njësitë bazë.</p> <p>-Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit Bachelor në "Higjenist Dentar", njësia bazë garanton përfshirjen e të gjithë strukturave, të cilat janë përgjegjëse për programin e studimit, siç është personeli akademik, ndihmës akademik e administrativ, sigurisht dhe të studentëve.</p> <p>-Nxitja dhe mbështetja e kërkimit shkencor do realizohen nëpërmjet zhvillimit të projekteve kërkimore të stafit akademik dhe përfshirjen e studentëve.</p> <p>-Në procesin e vlerësimit të brëndëshëm të programeve të studimit, institucioni ka përfshirë dhe një ekspert të jashtëm nga institucionet bashkëpunuese, proces të cilin GVJ e inkurajon.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi VI.5</b>	
<b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, për programin e studimit, janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare on line të Universitetit. Statuti, Rregulloret, vendime të senatit, etj, gjenden të publikuara në këtë faqe të hapur për publikun e interesuar. Informacionet përcillen dhe në formë shkresore në njësinë kryesore dhe njësitë bazë, ku janë të aksesueshme nga personeli akademik, ndihmës akademik dhe studentët. Raporti i NJSBC është publik dhe i aksesueshëm nga studentët dhe publiku në faqen ëeb të IAL: <a href="http://www.unireald.edu.al">ëëë.unireald.edu.al</a>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe	NJSBCB realizon pyetësorët institucional në fund të çdo viti akademik, të cilët publikohen rregullisht duke rritur transparencën. Në hartimin e raportit, NJSBC respekton lirinë akademike dhe kodin e etikës si dhe kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale (ligji 48/2012 "Për

<p>legjislaconin për të dhënat personale.</p>	<p>mbrojtjen e të dhënave personale”). Raporti i monitorimit i komunikohet strukturave e autoriteteve përkatëse, rezultatet e vlerësimit i komunikohen studentëve, raportet e vlerësimeve të personelit akademik e ndihmës akademik iu komunikohen stafit akademik. Institucioni publikon raportin e vetëvlerësimit të brendshëm për akreditimin institucional në faqen e vet elektronike, për të gjithë aktorët që kanë lidhje me universitetin dhe publikun e interesuar.</p> <p><b>(Intervista me stafin akademik dhe studimit; Ev. 16)</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit të brendshëm, të procesit të akreditimit raportohen pranë rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve. Në analizën e saj NJSBC-ja informon njësitë bazë dhe ato kryesore lidhur me pikat e forta dhe dobësitë e tyre. GVJ thekson se raportimet e kryera nga IAL janë raporte përshkruese. Këto raporte krahas rezultateve kanë dhe rekomandimet përkatëse apo adresim të problematikave, të cilat synojnë përmirësimin e mangësive dhe dobësive të evidentuara.</p> <p><b>(Takimi me stafin akademik, RVB; Ev. 104; Ev. 111)</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Nga shyrtimi i dokumentacionit GVJ konstatoi se FSHM dhe departamenti i Stomatologjisë, kanë zhvilluar një sërë aktiviteteve me studentët dhe stafin akademik për informimin, aftësimin e tyre për zgjidhjen e situatave të ndryshme në praktikën klinike, aktivitetet kërkimore-shkencore, konferenca shkencore e studentëve dhe stafit akademik në funksion të sigurimit dhe përmirësimit afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Vlen të theksohet dhe mbështetja e institucionit për stafin akademik, për rritjen e tyre profesionale, si pjesëmarrjen në aktivitete shkencore apo mbështetje financiare për botime në revista me faktor impakti.</p> <p><b>(Takimi me stafin akademik, RVB; Ev. 105)</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Me qëllim ngritjen e kulturës së cilësisë, institucioni organizon aktivitete dhe seminare informuese me studentët dhe personelin, me qëllim ndërgjegjësimin e tyre mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në procesin e përmirësisë së cilësisë së programeve të studimit dhe shërbimeve administrative që ata marrin në IAL. Këtë e realizojnë nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Takimeve të drejtpërdrejta me studentët;</li> <li>- Publikimeve të ndryshme në rrjetet promovuese online të KUR;</li> </ul>






	<p>- Publikimit të njoftimeve në llogaritë personale në SMI;</p> <p>Në mënyrë periodike organizohen në bazë departamenti apo fakulteti, aktivitete të ndryshme, seminare, ëorkshop, trajnime, leksione të hapura, konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, të organizuara me referues nga FSHM si dhe personel shëndetsor nga brënda dhe jashtë vëndit. Këto aktivitete janë edhe në ëebsite-in e KUR: <a href="https://unireald.edu.al/aktivitete-shkencore/">https://unireald.edu.al/aktivitete-shkencore/</a></p> <p><b>(Ev. 83; Ev. 84; Ev. 86; Ev. 87; Ev. 90; Ev. 113; Ev.116)</b></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>-Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare, on line të universitetit.</i></p> <p><i>-NJSCB realizon pyetësorët institucional në fund të çdo viti akademik, të cilët publikohen rregullisht duke rritur transparencën. Raporti i monitorimit u komunikohet strukturave e autoriteteve përkatëse, rezultatet e vlerësimit i komunikohen studentëve, raportet e vlerësimeve të personelit akademik e ndihmës akademik u komunikohen individëve dhe merren masat korrigjuese përkatëse.</i></p> <p><i>-Raportimet e kryera nga IAL janë raporte përshkruese. Këto aporte krahas rezultateve kanë dhe rekomandimet përkatëse apo adresim të problematikave të cilat synojnë përmirësimin e mangësive dhe dobësive të evidentuara.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X



**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Higjienitë Dentar”**

**a. Pikat e forta dhe afirmime:**

1. KUR ka demonstruar se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike të programit të studimit;
2. Programi i studimit garanton thëllimin e njohurive teorike dhe praktike, dhe zhvillon aftësitë profesionale të studentëve;
3. KUR garanton qëndrueshmërinë financiare për realizimin e objektivave dhe misionit të tij, bazuar në të ardhurat që siguron;
4. Infrastruktura, mjediset mësimore, teknologjia e informacionit, shërbimet për studentët janë të përshtatshme dhe në plotësim të standarteve për zhvillimin e një procesi cilësor mësimor;
5. Atmosfera akademike është pozitive, KUR demonstroi një shkallë të lartë kolegjaliteti;
6. Përfshirja e disa partnerëve për praktika dhe kontributi në mësimdhënie;
7. Institucioni ka mekanizma dhe aktivitete rreth mbështetjes së studentëve;

**b. Pika të dobta:**

1. Departamenti duhet të hartojë raporte analitike mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit; *(Standarti I.3, kriteri 4)*
2. Titullarët e moduleve duhet t'i përkasin kategorisë “Profesor”; *(Standarti II.3, kriteri 4)*
3. Në disa raste literatura e detyruar dhe e rekomanduar në syllabuse është e vjetëruar dhe në disa lëndë bazohet në leksionet e shkruara nga vetë pedagogët; *(Standarti IV.3, kriteri 2)*

**Rekomandime:**

1. Konsultime me grupet te ndryshme të interesit, për të përmirësuar programin e studimit në përputhje me kërkesat e tregut, krahas nxitjes në përfshirjen e studentëve për këto përmirësime;
2. KUR të marrë masa që titullarët e moduleve të jenë të kategorisë “Profesor”, në përputhshmëri me aktet ligjore;
3. KUR të rishikojë rregulloret, ku të tregohen mënyrat dhe mjetet që duhet të përdoren për shmangien e plagjiaturës, si dhe masat disiplinore që duhet të merren në raste të tilla;
4. GVJ rekomandon pasurimin e kësaj literature me libra të viteve të fundit, si dhe shtimin e literaturës fizike profesionale;



## **Evaluation's conclusions for the first cycle study program, Bachelor, "Dental Hygienist"**

### **a. Strengths and affirmations:**

1. HEI "REALD" has demonstrated that it has the appropriate experience, capacities, and resources in the specific academic field of the Study Program;
2. The study program guarantees the deepening of theoretical and practical knowledge and develops the professional skills of students;
3. HEI "REALD" guarantees financial stability for the realization of its objectives and mission, based on the income it provides;
4. The infrastructure, learning environments, information technology, and services for students are appropriate and meet the standards for the development of a quality learning process;
5. The academic atmosphere is positive HEI "REALD" demonstrates a high degree of collegiality;
6. Involvement of some partners for practices and contribution to teaching;
7. Institution has mechanisms and activities around student support;

### **b. Weaknesses:**

1. The department must draft analytical reports on the benefits from cooperation agreements in function of the realization of the study program; (*Standarti I.3, criterion 4*)
2. The holders of the modules must belong to the "Professor" category; (*Standarti II.3, criterion 4*)
3. In some cases the mandatory and recommended literature in the syllabus is outdated and in some subjects it is based on the lectures written by the lecturers themselves; (*Standarti IV.3, criterion 2*)

### **Recommendations:**

1. Consultations with different interest groups, to improve the study program in accordance with market requirements, in addition to encouraging the involvement of students for these improvements;
2. HEI "REALD" should take measures so that the holders of the modules are of the "Professor" category, in compliance with the legal acts;
3. HEI "REALD" should review the regulations, where the ways and means that should be used to avoid plagiarism, as well as the disciplinary measures that should be taken in such cases, are indicated;
4. Enrichment of the literature with books of recent years, as well as the addition of professional physical literature;



**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>

